

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7783 E hënë 4 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Është e vërtetë. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) e certifikoi (vërtetoi) rritjen tonë ekonomike mbi 4 për qind për vitin që kaloi në raportin e publikuar... *Vijon në faqen 21*

Nga FATOS ÇOÇOLI

Rritemi katër herë dhe prapë duam të ikim!



Opinion **Ditës**

Javën e aktiviteteve të OKB në përkujtim të Holokaustit Alison Smale e mbylli me një aktivitet për Shqipërinë. Ajo theksoi rolin e Shqipërisë në shpëtimin e hebrenjve... *Vijon në faqen 20*

Nga AIDA CAMA

Të gjithë sot kemi nevojë për besën!



Kritiku: Askush s' e bllokoi rotacionin e elitave në PD

Ish-zyrtari i PD, Aleksandër Biberaj: Ja ku ndryshon Berisha nga Basha

"Zgjidhja e krizës, zgjedhjet e parakohshme. Me protesta masive, s' ka qeveri që i reziston"

Nga VALENTINA MADANI

Aleksandër Biberaj e njeh PD-në që në qelizë... Prej saj nuk donte të largohet. Qëndroi larg PD-së për shkak të kritikave ndaj disa individëve apo segmenteve të pushtetit. Misionin e nisur që në 90-ën, dhe që e ndërpreu...

Në faqen 4-5

PRESIDENTI TAKON BANORET GREVISTE: QEVERIA DUHET TA RIBEJE PROJEKTIN

UNAZA, META PERPLASET ME RAMEN: E PALIGJSHME

Rama: Meta është drejtuesi më serioz i opozitës, budallallëkut i del për zot. Veliqaj: Zhgënjyese, nga presidenti anti-lodra tek ai anti-rrugë



(Në foto) Presidenti Ilir Meta, dje gjatë takimit me banorët e Astirit

Në faqen 2-3

LISTA E PLOTE
Kushtetuesja, 55 kandidatë për 6 vende, Sollaku në garë për 4 poste
Në faqen 6

DETAJET HORROR
Burg 7 të rinjve që përdhunuan të miturën në Kavajë, në kërkim një tjetër
Në faqen 7

LIFEPAGES
Ylli Merja: Si të eliminoni dhimbjet e kyçeve dhe kockave me lëngun e hithrës
Suplement

FAZA E DYTE
Fituesit e fundit në Tiranë, 664 emrat që aplikuan për 10 punësuar infermierë
Në faqen 17

PARA ÇMIMIT NOBEL



"La Repubblica" ngre shkrimtarin Kadare, boton; "Unë nuk kam frikë"
Në faqen 10-11

Pritet konfirmimi nga Instituti i Shëndetit Publik për llojin e virusit

Gripi i Derrit? Dy viktimat e para në Sanatorium

Burimet spitalore: Kishin komplikacione të rënda në mushkëri

Që prej së premtës, kanë humbur jetën 2 persona si pasojë e komplikacioneve të rënda në mushkëri, të cilët më parë ishin prekur nga gripi, çka shkaktoi komplikacione të rënda për ta. Përkatesisht, personat e moshës 47 dhe 41 vjeç, kanë mbërritur në gjendje tepër të rëndë



nga qytetit i Elbasanit me pneumoni bilaterale dhe insuficiencë gati totale të mushkërive shkaktuar nga agjentë viralë gripi. Ndërkohë, Instituti i Shëndetit Publik ende nuk ka një deklaratë zyrtare apo prononcim mbi llojin e virusit që i mori jetën...

Në faqen 9

UNAZA E RE PROJEKTI

Presidenti ka bërë publik qëndrimin e tij, përkrahë kërkesat e banorëve

Meta: Unaza paligjshmëri ekstreme, qeveria të ribëjë projektin

"Punimet në terren janë bërë pa leje ndërtimi"

Presidenti Ilir Meta ka dalë në krah të kërkesave të banorëve të Astirit dhe i ka kërkuar qeverisë dhe Këshillit Kombëtar të Rregullimit të Territorit të anulohet tërësisht projektin e zgjerimit të Unazës në segmentin nga Pallati me Shigjeta deri te Dogana. Kreu i Shtetit ka dalë dhe në një qëndrim zyrtar publik lidhur me këtë debat tremujor, duke argumentuar se projekti aktual para-qet shkelje të shumta ligjore dhe bie ndesh me interesin e banorëve të zonës dhe ka kërkuar që të hapet procesi për një projekt të ri.

PROBLEMATIKA

Në qëndrimin e tij, fillimisht Meta denoncon mungesën e transparencës nga institucionet përgjegjëse për ndërtimin e Unazës, ndërsa nuk nguron të theksojë se disa prej tyre refuzuan në mënyrë të përsëritur t'i përgjigjeshin edhe kërkesave të vetë Presidentit të Republikës. Ndaj nisur nga kjo ai vlerëson se kjo sjellje e institucioneve publike është jashtë qdo logjike normale të funksionimit të institucioneve shtetërore në një vend demokratik dhe se drejtuesit e këtyre institucioneve kanë kryer një shkelje të rëndë të Kushtetutës. Ndërkohë që nga gjithë informacioni që është administruar prej tij Kreut të Shtetit, thekson se ka arritur në bindjen se projekti para-qet shkelje të shumta ligjore, të cilat kërkojnë detyrimisht një rishikim të plotë dhe të menjëhershëm të vendimarrjes. Konkretisht, Presidenti i Republikës konstaton se hartimi i këtij projekti është kryer në mungesë të plotë të konsultimit publik dhe transparencës. Sipas tij pamundësia financiare shtetërore për të realizuar një projekt tërësor duke i ndarë dhe financiar ato vit pas viti me lote dhe të fragmentarizuar, nuk mund të përbëjë kursesi shkak ligjor për të shmangur procesin e konsultimit publik, kur një gjë e tillë është e detyrueshme me ligj. Gjithashtu, ai konstaton se hartimi i projekti nga një kompani private konsulence, pa garë dhe me kërkesë të ARRSH-së nëpërmjet një kontrate sponsorizimi është në kundërshtim të plotë me ligjin për prokurim publik dhe parimet që udhëheqin konkurrencën e lirë dhe të ndershme. Po ashtu Meta thekson se rezultoni e provuar se procedurat e tenderimit për realizimin e investimit në këtë segment rrugor janë shpallur; zhvilluar dhe kanë përfunduar ndërkohe që projekti nuk ishte miratuar ende nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Presidenti ka krijuar bindjen se ndarja në 3 lote është bërë me qëllim fragmentarizimin e



Presidenti Ilir Meta, dje gjatë takimit me banorët e Astirit



TENDERI

"Hapja e procedurave të tenderimit, pa një vendim të autoritetit vendimmarrës për miratimin ligjor të projektit Këshilli Kombëtar i Territorit, përveç se është shkelje e rëndë ligjore, krijon bindjen se ky proces ka qenë selektiv, i paracaktuar dhe në kushte ekstreme të kapërcimit me dashje direkte të procedurave të detyrueshme ligjore".

PROBLEMATIKA E KONSTATUAR NGA PRESIDENTI:

- Hartimi i këtij projekti është kryer në mungesë të plotë të konsultimit publik dhe transparencës.
- Ky projekt duhet të përfshinte jo vetëm vlerësimin mjedisor të detyrueshëm sipas ligjit, por edhe vlerësimin socialo-ekonomik, pasi efektet që sjell implementimi i tij prekin veprimtarinë tërësore të qytetit të Tiranës dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat jetikë të banorëve të kësaj zone.
- Veprimi i ARRSH për të hartuar një Projekt Rehabilitimi për këtë segment rrugor, pa kryer një konsultim publik të hapur me banorët si palë të interesuar krijon bindjen se është kryer me qëllim për të shmangur dëgjuesat publike dhe opinionet që mund të paraqiteshin në funksion të përmirësimit të projektit në të gjitha aspektet.
- Rezultoni se, projekti është hartuar nga një kompani private konsulence, pa garë dhe me kërkesë të ARRSH-së nëpërmjet një kontrate sponsorizimi. Kjo praktikë e ndjekur nga ARRSH, është në kundërshtim të plotë me ligjin për prokurim publik dhe parimet që udhëheqin konkurrencën e lirë dhe të ndershme.
- Përzgjedhja e një procedure sponsorizimi me arsyetimin se është kursyer buxheti i shtetit, është vetëm një alibi.
- Ky projekt i duruar, pa garë dhe i pakonsultuar me publikun nuk reflekton shqësitë dhe interesat e komunitetit dhe gjithë palëve të interesuara.
- Rezultoni e provuar se procedurat e tenderimit për realizimin e investimit në këtë segment rrugor janë shpallur, zhvilluar dhe kanë përfunduar ndërkohe që projekti nuk ishte miratuar ende nga Këshilli Kombëtar i Territorit.
- Ndarja në 3 lote është bërë me qëllim fragmentarizimin e fondeve në dispozicion, ruajtjen e kujtije monetarë me qëllim shmangjen e kompanive ndërkohe të këtyre procesit tenderimi.
- Siç është faktuar publikisht konkurrimi në të tre lotet ka qenë fiktiv. Në çdo lot kanë konkurruar dy kompani, ku e njëjta kompani në të tre lotet ka dhënë ofertë ekonomike me vlerë zero! Kjo provon qartazi realizimin e një procesi tenderimi të trukur.
- Një nga kompanitë fituese të tenderit (DH Albania) ka rezultuar një kompani e krijuar rishtazi me një historik fiktiv dhe me dokumente të paraqitura të falsifikuara.
- Leja e Zhvillimit e miratuar më dt 20 nëntor 2018, është dhënë pa një informacion të plotë dhe të saktë mbi statusin e pronësisë së pasurive të paluajtshme mbi të cilat do të ndërtohet vepra.
- Rezultoni se, Këshilli Kombëtar i Territorit me urgjencë ka miratuar në datë 20.11.2018, Lejen e Zhvillimit për këtë projekt, pa verifikuar statusin e pronësisë të pasurive ku shtrihet ky projekt.
- Autoritetet publike kanë realizuar ndërhyrje për prishjen e objekteve në terren, pa ndjekur procedurat ligjore dhe pa asnjë njoftim paraprak zyrtar, duke sjellë një situatë tensioni dhe pasigurie jetike tek secili prej banorëve të prekur nga ky projekt.
- Janë shkelur rëndë dhe me kokëfortësi të drejtat themelore kushtetuese të njeriut. Për më tepër, kjo sjellje presioni, intimidimi mbi banorët, familjarët dhe fëmijët e tyre kanë shkakuar trauma psikologjike me pasojë shëndetësore dhe sociale.
- Rezultoni se KKT nuk ka dhënë Leje Ndërtimi për realizimin e punimeve sipas këtij projekti të miratuar.
- Procesi i trajtimit të këtyre objekteve sipas ligjit të legalizimit është tërësisht jashtë qdo logjike të funksionimit të shtetit ligjor, pasi ka një mungesë të theksuar të transparencës në këtë drejtim.

Zëdhënësi i presidentit: Shtëpia me tjegulla dhe shteti me rregulla

Presidenti Ilir Meta i është përgjigjur dje deklaratave të kryeministrit Edi Rama përmes zëdhënësit, Tedi Blushi lidhur me përplasjen me të fundit mes dy institucioneve, për Unazën e Madhe. Përmes një reagimi për mediat zëdhënësi i presidentit të quajti jo serioz reagimi i Ramës, ndërsa sqaroi se vlera e fondit limit të tenderit të shpallur nga ARRSH për Lotin 1 është thuajse e barabartë vlerën e kontratës së lidhur me kompaninë fiktive "DH Albania", çka tregon faktivitetin e një tenderi të tillë. Gjithashtu, ai iu referuar edhe



qështjes së sigurimit të kontratës së lidhur me DH Albania, duke i shtruar një pyetje të drejtpërdrejtë qeverisë dhe Ramës nëse ishte konfiskuar shuma e siguruar prej 10 për qind e kontratës. "A ka kërkuar sipas rregullave të prokurimit publik qeveria

dhe ARRSH konfiskimin e kësaj vlere (sigurimin e kontratës) për llogari të shtetit shqiptar, pasi u faktua se kontratën e kishin lidhur me një kompani fantazëm? A ka mundur shteti të garantojë interesin publik në këtë rast, duke konfiskuar sigurimin e kontratës, apo edhe ky dokument (sigurimi i kontratës) ka qenë i falsifikuar? Këto dhe shumë detyra të tjera, ligji ia ngarkon Kryeministrit dhe vartësve të tij që t'i bëjnë. Shtëpia me tjegulla dhe shteti me rregulla, thotë qytetarëve. Po ashtu, presidenti kërkon që të trajtohen edhe personat që kanë prona të palegalizuara dhe nëse është e nevojshme të bëhen edhe ndryshime ligjore që të legalizohet edhe to. Nga ana tjetër, ai kërkon që procedurat e tenderimit për projektin e ri të jenë transparente dhe të hapen ndërkohe tërësisht.

QËNDRIMI

Pas kësaj analize dhe konstatimit sipas tij të paligjshmërisë ekstreme presidenti kërkon që Këshilli i Ministrave dhe KKT duhet të anulohet menjëherë projektin. Ndërkohë Meta kërkon që Ministria e Infrastrukturas dhe ARRSH të ndërpresin dhe të anulohet menjëherë çdo procedurë prokurimi që po realizohet bazuar në projektin ekzistues me qëllim ruajtjen e financave publike dhe shmangjen e çdo pasojë negative për interesin publik dhe cenimin të drejtave të pronësisë së

qytetarëve. Pas kësaj Meta kërkon të nisin procedurat me garë të hapur për të realizuar një Projekt të Ri, i cili do të duhet të ofrojë zgjidhjen në të mirë teknike për zhvillimin urban të Tiranës dhe interesave të qytetarëve. Po ashtu, presidenti kërkon që të trajtohen edhe personat që kanë prona të palegalizuara dhe nëse është e nevojshme të bëhen edhe ndryshime ligjore që të legalizohet edhe to. Nga ana tjetër, ai kërkon që procedurat e tenderimit për projektin e ri të jenë transparente dhe të hapen ndërkohe tërësisht.



Kreu i qeverisë ka reaguar pas qëndrimit publik të presidentit për Unazën

Rama: Meta drejtuesi më serioz i opozitës, budallallëkut i del për zot

Spiropali: Presidenca e ngjashme me simotrën PD dhe sigruan LSI

Dy nga institucionet më kryesore në vend, kanë humbur jo "dashurinë por edhe qetësinë" e marrëdhënieve mes tyre. Për të tretën herë në harkun e dy muajve, institucionet e Presidentit të Republikës dhe ai i Kryeministrit janë përfshirë në një debat të ashpër, ku nuk kanë kursyer as etikën. Kësaj here shkak është bërë pikërisht ndërhyrja e kreut të shtetit në debatin për projektin e zgjerimit të Unazës së Re në segmentin nga Pallati me Shigjeta deri te Dogana. Vetëm pak minuta pasi presidenti Ilir Meta bëri publik qëndrimin e tij ndaj këtij projekti, erdhi dhe reagimi i ashpër i kryeministrit Edi Rama, i cili nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale e konsideroi atë si kreun e opozitës. Nëpërmjet ironisë, kryeministri theksoi se Meta ishte drejtuesi më serioz i opozitës, ndërsa shprehej se njësoj si partitë opozitare qeverinë e urtente njësoj. Ndërkohë që duke iu referuar argumentit që Meta paraqiste në qëndrimin e tij për projektin e Unazës, Rama i konsideroi ato si dokrra ligjore. "E vërteta është se Ilir Meta është drejtuesi më serioz i opozitës. Kushtetutën e lexon njësoj si ata. Qeverinë e urren njësoj si ata. Rrëmuajtën e uron njësoj si ata. Po ndryshe nga ata, ai i ul vartësit të mbushin çarçafë me dokrra "ligjore" dhe budallallëkut i del për zot pa pikën e gajlës", - shkroi Rama



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

REAGIMI

"E vërteta është se Ilir Meta është drejtuesi më serioz i opozitës. Kushtetutën e lexon njësoj si ata. Qeverinë e urren njësoj si ata. Rrëmuajtën e uron njësoj si ata. Po ndryshe nga ata, ai i ul vartësit të mbushin çarçafë me dokrra "ligjore" dhe budallallëkut i del për zot pa pikën e gajlës", - shkroi Rama

Basha në Fier: Zgjedhje të lira me Niçen, me Gjushin dhe Ramën

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha vijoi Me Fierin turin e tij të takimeve me qytetarët në kuadër të përgatitjeve për protestën e 16 shkurtit. Gjatë takimeve të rastësishme Basha tha se opozita nuk do të ndalet deri në largimin qeverisë, dhe çlirimin e ekonomisë dhe vendit nga krimi dhe oligarkia, ndaj i ftoi ata të bashkoheshin në protestë në 16 shkurt. "Dëshpërimi, humbja e shpresës, dyshimi, mosbesimi, janë armët e fundit të kësaj bande në pushtet. Ne ju ftojme me 16 shkurt të vini të gjithë në Tiranë dhe t'ia hedhim në Lanë këto armë, bashkë me propagandën, në mënyrë që të gjithë së bashku të rindezimin motorët e ekonomisë, të rindezimin motorët e mirëqenies, përmes lirive, mundësive dhe punësimit, që do t'i bëjmë realitet me planin tonë ekonomik", - u shpreh Basha. Ai u ndal edhe në Frakull në një bashkëbisedim me banorët dhe fermerët ku premtoi një paketë me taksë të ulëta dhe subvencione për ta, ndërsa i ftoi të protestojnë kundër qeverisë. "Ne, mjete politike, veç zgjedhjeve, për të ardhur në pushtet, nuk kemi. Por zgjedhje të lira e të ndershme me Niçen, me Gjushin, me Ramën, nuk ka. Kjo është arsyeja që ju kemi thirrur në një protestë në 16 shkurt. Sepse këtë zgjedhje mund ta jepni vetëm ju si popull. Nuk ju kam thirrur për të mbajtur fjalime më 16 shkurt", - shtoi Basha.



Veliaj: Zhgënjyese, nga presidenti anti-lodra tek ai anti-rrugë

Pas kryeministrit, Edi Rama, ka ardhur edhe reagimi i kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj për qëndrimin e mbajtur gjatë ditës së sotme nga Presidenti i Republikës, Ilir Meta. Nëpërmjet disa reagimeve në rrjetet sociale, kryebashkiaku Veliaj theksoi se Unaza e Re i duhet Tiranës dhe se institucionet kanë ofruar strehim falas për ata që janë të pastrehë dhe shpronësuar qind për qind për atë që i kanë pronat me letra. "Do që zhgënjyese nëse vemi nga Presidenti anti-lodra tek ai anti-rrugë! Mos saboto Tiranën", shkroi Veliaj në reagimin e tij. Më tej ai theksoi se 99 për qind e qytetarëve të Tiranës e duan Unazën dhe nuk duan që të bllokohen nga trafiku që shkaktojnë çdo ditë një pakicë e vogël që proteston duke bllokuar rrugën. "Çdo ditë, për orë të tëra, bllokohen në Unazë e Re nga protestat me djegie gomash e hunjsh dhe grupseksionet e dhunshme të PD Kamëz, 99% e qytetarëve të Tiranës që as kanë zaptuar e as bëjnë lojëra politike. Nëse presidenti inkurajon këtë 1% të hurit e zjarrit, kot që flasim", shkruan Veliaj në një tjetër reagim.

Këshillit Kombëtar të Rregullimit të Territorit të anuloi tërësisht projektin e zgjerimit të Unazës në segmentin nga Pallati me Shigjeta deri te Dogana. Kreu i Shtetit ka dalë dje në një qëndrim zyrtar publik lidhur me këtë debat tremtur, duke argumentuar se projekti aktual paraqet shkelje të shumta ligjore dhe bie nënsh me interesin e banorëve të zonës dhe ka kërkuar që të hapet procesi për një projekt të ri.

Banorët e Astirit priten nga Meta, policia ndalon njërin prej tyre

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti dje me kërkesë të tyre një përfaqësi të banorëve të "Unazës së Re", banesat dhe pronat e të cilëve preken nga projekti i segmentit rrugor "Mbi-kalimi i pallatit me shigjeta-Rrethrrrotullimi i sheshit Shqiponja". Gjatë kësaj degëse me qytetarët, Presidenti Meta u informua në detaje, në lidhje me të gjitha shtetësimet dhe problematikat e këtij komuniteti që ende nuk janë zgjidhur nga institucionet përkatëse. Ndërkohë që banorët kanë dalë nga Presidenca, raportohet të jetë ndaluar nga policia njëri prej tyre. Bëhet fjalë për shtetasin Kujtim Ylli, për të cilin ka pasur më herët një urdhër ndalimi nga prokuroria. Ai është shoqëruar pranë ambienteve të komisarariatit nr.6 në Tiranë ku i janë bërë të gjitha verifikimet dhe ka rezultuar se urdhri i ndalimit ishte i paligjshëm.

PD: Fituesi për parkimet në Tiranë është i paracaktuar

Partia Demokratike ka denoncuar procedurën e Bashkisë së Tiranës për fituesin e parkimeve publike. Zëdhënësi dhe kësaj force, Ina Zhupa bëri të ditur dje se në mbledhjen e fundit të këshillit bashkiak u vendos dhënia tek një privat e shërbimit të parkimeve për të rritur format e pagesës dhe sigurisht edhe pagesën. "Sipas vendimit, Tirana Parking duhet të hapë procedurën konkurruese për përzgjedhjen e fituesit. Ndërkohë fituesi mesa duket është paracaktuar nga Veliaj muaj më parë. Mesa duket fituesi do jetë kompania: Pay and Go shpk, regjistruar në shkurt 2015, si shoqëri e krijuar nga shoqëria "UNTAG COMMUNITY", me seli në Angli dhe Uells në pronësi të një georgjiani, e cila rezultoi të jetë një kompani OFFSHORE e regjistruar në parajsë fiskale", - shkroi Zhupa duke hedhur dyshime për paracaktim të fituesit të mbledhjes së pagesave.

AKSIONI I OPOZITES

INTERVISTA

Ish-deputeti: Situata e vështirë, s'ka vend për hatërmbetje, por për bashkim në PD

Biberaj: Me protesta masive, s'ka qeveri që i reziston

"Zgjidhja e krizës, zgjedhjet e parakohshme"

Valentina Madani

Aleksandër Biberaj e njeh PD-në që në qelzë... Prejsaj nuk donte të largohej. Qëndroi larg PD-së për shkak të kritikave ndaj disa individëve apo segmenteve të pushtetit. Misionin e nisur që në 90-ën, dhe që e ndërpreu vetëm përkohësisht z.Biberaj ka vendosur ta vazhdojë... Ndaj u rikthye në forumet drejtuese të partisë, i zgjedhur me votë si antar i Këshillit Kombëtar të PD-së. Ish-deputeti demokrat Aleksandër Biberaj, tregon për "Gazeta Shqiptare", arsyet e ikjes dhe rikthimit në PD, abuzimin e ish-pushtetarëve të djathtë, të cilët sipas tij sot shijojnë parajsën ndërkohë që demokratët i kaluan në opozitë. Aleksandër Biberaj flet për marrëdhënien me Lulzim Bashën, prishmëritë e tij për të risjellë demokratët në pushtet, rrotacionin e elitave dhe brezave në PD, qeverinë hije sot në opozitë dhe reale nesër në pushtet.

Z.Biberaj, si ishte për ju rikthimi në PD pas kaq vitesh?

Duke iu falënderuar për intervistën në gazetën tuaj, një ndër gazetën më të vjetra në historinë e Shqipërisë, dëshiroj të theksoj se jam rikthyer në Partinë Demokratike direkt pas humbjes së zgjedhjeve të vitit 2013, besoj që mbahet mend pasi media e ka përcjellë si lajm në atë kohë. Ndërkohë kam qenë pjesë e strukturave lokale të PD-së në Njësinë Nr. 5 Tiranë, sekretar i seksionit ku edhe banoj. Kam marrë pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet politike të PD-së, por me sa duket aktiviteti im duke qenë në nivel lokal, ka ngulur jashtë vëmendjes mediatike. Gjatë këtyre viteve i jam përkushtuar karrierës akademike, duke qenë lektor në Shqipëri, por edhe në Kosovë, Maqedoni dhe vende të tjera, e cila mbe-

tet një eksperiencë e jashtëzakonshme që më vlen shumë.

Çfarë ju riktheu në forumet drejtuese të PD-së, konkretisht në Këshillin Kombëtar?

Duke qenë një themelues i PD-së, dhe një përfaqësues i brezit dhe frymës së Dhjetorit '90, gjykova se misioni im kishte mbetur përgjysmë, i pareaizuar, dhe u ktheva për të dhënë kontributin tim modest për të realizuar misionin e atij brezi që është edhe misioni i çdo shqiptari sot e kësaj dite, një mision për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe për demokracinë si sistem vlerash, për një shtet të së drejtës, për një ekonomi të tregut të lirë ku dominon konkurrenca e lirë dhe e ndershme, për një Shqipëri anëtare të BE-së, për një parlament elitari, për një qeverisje profesionale që punon për qytetarët e vet dhe jo për vete, për një sistem drejtësie që bazohet në ligj dhe që respekton dhe zbaton ligjin në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, dhe mbi të gjitha për interesin

kombëtar që qëndron dhe prevalon mbi çdo interes tjetër. Gjithashtu, u riktheva në forumet drejtuese të PD-së pasi e pashë që punët e vendit po shkojnë keq e më keq, dhe gjykova se vendi ka nevojë edhe për kontributin tim modest. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se politikën e kam pasion dhe profesion, dhe gjykoj se nuk ka gjë më fisnike sesa t'iu shërbesh qytetarëve të vendit tënd.

Çfarë ka ndryshuar që nga koha që ju u larguat nga PD dhe deri në zgjedhjet tuaj si anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së?

E para, nuk u largova nga Partia Demokratike, por më larguan, dhe e dyta kritikak e mia ndaj qeverisë (kohë kur PD qeveriste e vetme ose me LSI-në) ishin parimor dhe drejtëshin ndaj individëve apo segmenteve të pushtetit që nuk punonin për interesin e shqiptarëve dhe demokratëve, por për interesat e tyre private dhe klanore"-tha ish-deputeti i PD-së.

LARGIMI
"E para nuk u largova nga Partia Demokratike, por më larguan, dhe e dyta, kritikak e mia ndaj qeverisë (kohë kur PD qeveriste e vetme ose me LSI-në) ishin parimor dhe drejtëshin ndaj individëve apo segmenteve të pushtetit që nuk punonin për interesin e shqiptarëve dhe demokratëve, por për interesat e tyre private dhe klanore"-tha ish-deputeti i PD-së.

të pushtetit që nuk punonin për interesin e shqiptarëve dhe demokratëve, por për interesat e tyre private dhe klanore. Siç thoshte i madhi Churchill "Problemi është gjithmonë qeverisja", dhe kritikak e mia synonin përmirësimin e qeverisjes së PD-së. E treta dhe më e rëndësishmja, është se u ktheva në PD në vitin 2013, kur Partia Demokratike doli në opozitë. Është koha kur të gjithë ata që përmenda më sipër, duke abuzuar me pushtetin dhe votën e demokratëve e çuan PD-në në opozitë, harruan anëtarët, simpatizantët, militantët dhe aktivistët demokratë që ngelën rrugëve, u larguan nga PD dhe vazhdojnë të shijojnë parajsën që kanë ndërtuar në mënyrë abuzive me pushtetin dhe votën e demokratëve. Unë që kisha qenë në opozitë më këta pushtetarë u ktheva në Partinë Demokratike për të vazhduar misionin tim, pasi opozita është mision, se për pushtet gjen njerëz sa të duash, ndërsa të sakrifkosh, të qëndrosh, të rezistosh në opozitë është një mision tepër fisnik. Natyrisht që unë opozitën nuk e kam për herë të parë, pasi jeta ime politike përgjithësisht ka kaluar në opozitë, përfshirë opozitën zyrtare me kundërshtarët politikë në vitet e



Ish-deputeti demokrat Aleksandër Biberaj

vështira 1991-1992, 1997-2005, dhe opozitën brenda llojit në vitet 2009-2013.

Si janë marrëdhëniet tuaja me kreun e PD-së Lulzim Basha?

Me Zotin Basha gjithmonë kam pasur marrëdhënie shumë të mira dhe tepër korrekte, marrëdhënie që bazohen në frymën e bashkëpunimit, mirëbesimit dhe respektit reciprok. Kemi bashkëpunuar në Komitetin e Orientimit të Politikave të cilin z.Basha e drejtoi për hartimin e programit electoral të fitores së zgjedhjeve të vitit 2005. Kemi bashkëpunuar po ashtu me z. Basha kur ishte Ministër i Transporteve dhe Telekomunikacioneve për reformat në sektorin e telekomunikacioneve, dhe natyrisht bashkëpunimi më i rëndësishëm ka qenë në kohën

demokratëve për integrimin e Shqipërisë në BE, për liberalizimin e vizave, për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO si dhe sfida mbarëkombëtare për lobingun për pavarësinë e Kosovës dhe njohjet ndërkombëtare të saj, ku Z. Basha si Ministër i Jashtëm ka bërë një punë të shkëlqyer duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm.

Ju keni bashkëpunuar gjatë në politikë me Sali Berishën, ndërkohë që u shkëputët kur në krye të PD-së ishte Z. Berisha, për t'u rikthyer kur në krye të PD-së erdhi Lulzim Basha. A shikoni diferenca në këto dy kohë dhe në gjykimin tuaj ku çalon PD nën drejtimin Z. Basha, cilat janë defektet që duhet t'i korrigjojë?

Është e vërtetë që kam

HL VLERËSIMI

"PD pas zgjedhjeve dhe ripërtëritjes së forumeve drejtuese po ravijëzohet çdo ditë e më shumë si forcë qeverisëse, ndërsa Z. Basha e vlerësoj si lider të PD-së dhe të së djathtës, dhe e shoh që çdo ditë po kontohet si kryeministri i ardhshëm model perëndimor i Shqipërisë",- tha ish deputeti i PD-së.

kur Z. Basha ishte Ministër i Jashtëm, ndërsa unë kisha pozicionet e Zv. Presidentit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe Zv. Presidentit të Grupit Parlamentar të Partive Popullore Europiane. Ishte koha e reformave të suksesshme të qeverisë së

punuar gjatë me Dr. Berishën, për rreth dy dekada, në nivele dhe pozicione të ndryshme, por asnjëherë nuk kam qenë afër tij, në rrethin e ngushtë të tij. Gjithsesi, gjatë këtyre dy dekadave bashkëpunimi, kemi pasur një marrëdhënie korrekte dhe



Kritikët, ish-zyrtari i PD: Askush s'mund ta bllokojë rotacionin e elitave në PD

Biberaj: Qeveria hiqe sot në opozitë, reale nesër në pushtet

"Bashkëpunimi, ku ndryshon Berisha nga Basha"

fundit dhe kë duhet të afrojë ajo në radhët e saj?

Jo nuk mendoj se PD është tkurrur, natyrisht duhet kuptuar që humbja e zgjedhjeve gjithmonë përbën një moment shokues për çdo parti. Sot Partia Demokratike është e mirëorganizuar dhe me lidhshmëri dhe me lidhshmëri e ri ajo po përfiton për të ardhur në pushtet. PD po rritet çdo ditë si parti, dhe shqiptarët po e shohin si një alternativë serioze dhe të përgjegjshme qeverisëse. Siç e thashë edhe me lart, PD-ja mbetet e hapur për çdo individ apo grup që është në opozitë me qeverisjen aktuale.



dhe është krejt normale që Z.Basha si lider i ri i PD-të të promovojë dhe të punojë me një lidhshmëri të ri. Besoj se ish-lidhshmëri që drejtoi fushatat nëpër qarqe në vitin 2013 ka përgjegjësi jo të vogël në humbjen e zgjedhjeve të atij viti dhe daljen e PD-së në opozitë. Gjithsesi mbetet në vullnetin e çdo individi që të japë kontributin e tij në PD, ose të bëjë opozitën e opozitës siç edhe po e bëjnë, që është një deformim tipik shqiptar apo ballkanas i demokracisë, pasi problemi kryesor është qeverisja dhe jo opozita.

Si e konsideroni deklaratën e ish-themeluesit të PD-së Neritan Ceka kur shprehet: Turp për PD-në që rri rrugëve, të l'lerë budalliaqet dhe të kthehet në parlament...

Nuk kam dëshirë që të komentoj deklaratat e tjerëve, por më duket një deklaratë e vjetër, pasi siç dihet Partia Demokratike është në parlament, dhe jo më larg se ditën

KRIKAT
"U ktheva në PD në vitin 2013, kur PD doli në opozitë. Është koha kur të gjithë ata që përmenda më sipër, duke abuzuar me pushtetin dhe votën e demokratëve e çuan PD-në në opozitë, harruan anëtarët, simpatizantët, militantët dhe aktivistët demokratë që ngelën rrugëve, u larguan nga PD dhe vazhdojnë të shijojnë paraejzen që kanë ndërtuar në mënyrë abuzive me pushtetin dhe votën e demokratëve", -tha z.Biberaj.

Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të PD-së, z.Basha kërko mobilizimin e të gjithë demokratëve për të nisur një sezon protestash, të cilat do të kulmojnë me largimin e Edi Ramës. Sa të mundur e shikoni ju këtë?

Natyrisht që me protesta masive, të qëndrueshme, të vazhdueshme, dhe me pjesëmarrje të gjerë, nuk ka qeveri që reziston, aq më tepër qeverisja aktuale që është konsumuar totalisht, nuk po qeveris, dhe çdo ditë që rri në pushtet vetëm dëm bëjnë. Jam optimist se protestat do të jenë suksesshme.

Sipas jush sa të motivuar do të jenë shqiptarët për t'ju përgjigjur thirrjes së opozitës për protestën e 16 shkurtit kundër Edi Ramës?

Shqiptarët janë më të motivuar se kurrë për të protestuar me 16 shkurt, pasi arsytet janë të shumta, duke filluar që nga kriza

← një bashkëpunim të frytshëm, gjë që e vlerësoj. Natyrisht që Z. Berisha dhe Z. Basha, përfaqësojnë dy modele të ndryshme lidhshmëri, dy breza të ndryshëm, dy shkolla të ndryshme politike dhe kanë drejtuar PD-në në dy kohë të ndryshme dhe rrethana të ndryshme, kështu që çdo krah asim do të ishte subjektiv. PD pas zgjedhjeve dhe ripërtëritjes së forumeve drejtuese po ravijëzohet çdo ditë e më shumë si forcë qeverisëse, ndërsa z. Basha e vlerësoj si lider të PD-së dhe të së djathtës, dhe e shoh që çdo ditë po konturohet si kryeministri i ardhshëm model përmëdorim i Shqipërisë.

Nisur nga lista e propozuar nga Z. Basha për anëtarë në Këshillin Kombëtar të PD-së, por edhe në kryesi, duket se ka një tentativë për të afruar sa më shumë kontribues të PD-së në strukturat të larta të partisë. Sipas jush kush tjetër duhet t'i bashkohet PD-së?

Si lista për Këshillin Kombëtar, ashtu edhe ajo për kryesinë dhe sekretariatën, gjykoj se ishin lista shumë të mira, ku respektohen ekuilibret dhe balancat në PD, respektohen vlerat dhe kontributet, si dhe përfaqë-

sohen të gjitha flukset që nga themeluesit e PD-së dhe deri tek më të rinjtë që janë studentët e sotshëm. Dhe ajo që është më e rëndësishmja, asnjë nga anëtarët e forumeve drejtuese të PD-së nuk ka asnjë akuzë publike, pra janë persona të pastër. Mendoj se është moment për t'u bashkuar me PD-në të gjitha ata demokratë që kanë kontribuar ndër vite dhe në pozicione të ndryshme, që nga themelimi i PD-së dhe deri më sot, dukë lënë mënjane hatermbetjet apo qoftë edhe zhgënjimet e ndryshme. Natyrisht që Partia Demokratike mbetet e hapur për çdo qytetar sh-

"TKURRJA"

"Jo nuk mendoj se PD është tkurrur, natyrisht duhet kuptuar që humbja e zgjedhjeve gjithmonë përbën një moment shokues për çdo parti. Sot Partia Demokratike është e mirë-organizuar dhe me lidhshmëri e ri ajo po përfiton për të ardhur në pushtet", -tha z.Biberaj.

qiptar që është i pakënaqur me këtë qeveri, për çdo qytetar që është në opozitë me këtë qeveri.

A shikoni një tkurrje të PD-së përgjatë viteve të

ekonomike, ekonomia informale bazuar në paratë e pista që prish tregun dhe dëmton konkurrencën, taksat e larta që shtohen çdo ditë, papunësia, pagat dhe pen-

sionet e uleta, varfëria ekstreme, problemet me rendin dhe sigurinë publike, mungesat në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet publike, cilësia e dobët e arsimimi, vrasja e shpresës për të ardhmen sidomos për rininë, em-

vidë me integritet, të mirëarsimuar, me karriera profesionale të suksesshme dhe me kontribute politike, dhe mbi të gjitha janë individë të pastër.
Cila është përgjegjësia juaj për kritikët e kryesisë së re

PROTESTA

"Natyrisht që me protesta masive, të qëndrueshme, të vazhdueshme, dhe me pjesëmarrje të gjerë, nuk ka qeveri që reziston, aq më tepër qeverisja aktuale që është konsumuar totalisht, nuk po qeveris, dhe çdo ditë që rri në pushtet vetëm dëm bëjnë. Jam optimist se protestat do të jenë suksesshme",- theksoi Aleksandër Biberaj.

igracioni i detyruar, etj...etj.

Zgjedhja e nënkryetarëve, Sekretari i Përgjithshëm, Kryesia e re, a besoni se prej tyre do përfitohet qeveria hiqe e PD-së?

Ky është lidhshmëri e ri i PD-së që do ta çojë PD-në në fitore, dhe krejt natyrisht që qeveria hiqe sot në opozite dhe reale nesër në pushtet vjen nga ky lidhshmëri, ndonëse gjykoj se qeverisja është një koncept më i gjerë dhe gjithëpërfshirës.

Si e shikoni ekipin e ri të z. Basha të dalë nga zgjedhjet e brendshme në PD, pjesë e të cilit jeni edhe ju vetë? Pjesa më e madhe e sekretariateve përbëhet nga njerëz teknikë. A frymëzojmë ky ekip i ri, sipas jush?

Siç e përmenda edhe më sipër ky ekip patjetër që frymëzojmë, është një ekip përfaqësues që ngjall shpresë dhe besim, dhe përbëhet nga indi-

të PD-së?

Gjykoj se kritikët nuk duhet të jenë paragjykoës, dhe të nguten me gjykime dhe vlerësime përpara kohë. Çdo individ i duhet dhënë kohë dhe mundësi për të treguar vlerat, aftësitë dhe performancën e vet.

Pas zgjedhjes së kryesisë së re, ish-nënkryetarja e PD-së, Jozefina Topalli, hodhi kritika në drejtim të Lulzim Bashes, duke e cilësuar lidhshmëri e ri si pa identitet. Si i vlerësoni këto kritika të ish-funksionarëve Topalli, Bode?

Gjykoj se politika si gjithçka tjetër në jetën dhe botën tonë zhvillohet me cikle, dhe çdo njeri besoj duhet ta kuptojë se vjen një ditë që mbyllet një cikël lidhshmëri ku ke qëndruar me vite dhe dekada, pasi kjo është dinamika dhe dialektika edhe e jetës politike. Askush nuk mund të bllokojë rrotacionin e elitave dhe brezave,

e enjte ishte në parlament.

Sa të mundshme i shikoni zgjedhjet e parakohshme parlamentare?

Me krizën shumëplanëshe aktuale, zgjedhjet e parakohshme i shoh jo vetëm si mundësi reale, por edhe si nevojë dhe domosdoshmëri që çon edhe në zgjidhjen e krizës.

Si do të vijë PD-ja në pushtet dhe a është ajo gatit të qeverisë ndryshe shqiptarët?

Partia Demokratike do të vijë në pushtet me zgjedhje të lira dhe të ndershme sipas standardeve ndërkombëtare, me një program që përfaqëson dhe mbrojnë interesat e qytetarëve shqiptarë dhe të kombit, dhe me një ekip profesionistësh dhe njerëzish të ndershëm, të përkushtuar dhe patriotik, që po ngjallin shpresën dhe besimin te shqiptarët që ky vend mund të bëhet.

Lista e plotë e gjyqtarëve dhe juristëve që kërkojnë të bëhen pjesë e Kushtetueses

Gjykata Kushtetuese, aplikojnë 55 kandidatë për 6 vende gjyqtarësh

Theodhori Sollaku ka aplikuar për 4 vende

Gjykata Kushtetuese prej disa muajsh tashmë, për shkak se shumica e anëtarëve të saj nuk kaluan dot procesin e vetëingut, por edhe se një pjesë e tyre u ka mbaruar mandati, ka hyrë në kolaps të plotë. Pas shkarkimit nga Komisioni i Apelit të vetëingut të kryetarit të saj, Bashkim Dedja, kjo gjykatë praktikisht ka mbetur pa asnjë anëtarë me mandat. De facto ajo ka vetëm një anëtarë, Vitore Tushën, por edhe ajo me mandat të përfunduar që para dy vitesh, pavarësisht se vijon të konsiderohet ende anëtarë e Gjykatës Kushtetuese. Procesi i ringritjes së këtij institucioni të rëndësishëm, garant i zbatimit të drejtë të Kushtetutës, duket se është peng i institucioneve që kanë të drejtën të bëjnë propozimet dhe emërimet dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi që duhet të bëjë vlerësimin për secilin kandidat.

PROCESI

Por ndërsa institucionet që në bazë të ligjit kanë të drejtë të bëjnë propozimet dhe në mënyrë konkrete, Kuvendi, Presidenti dhe Gjykata e Lartë e kanë përmbyshur deri diku detyrimin e tyre ligjor, topi tashmë mbetet në fushën e KED, i cili duhet të miratojë një rregullore të posaçme për vlerësimet e kandidatëve dhe më pas të bëjë vlerësimin e secilit kandidat të paraqitur. Në total tek të tria institucionet, pra në Kuvend, Presidencë dhe në Gjykatë të Lartë janë bërë plotë 55 aplikime për 6 vende në Gjykatën Kushtetuese, ndërkohe që për tre vendet e tjera ose nuk është hap procesi i aplikimit ose ka dështuar për mungesë të kandidatëve. Duhet thënë se shumë prej kandidatëve kanë aplikuar disa herë për vende vakante të ndryshme.

KANDIDATËT

Kuvendi nga ana e tij e ka përmbyshur detyrimin e tij ligjor, pasi ka mundur të mbyllë procesin e aplikimeve për kandidatë për tre vendet e tija në Gjykatën Kushtetuese. Më konkretisht për vendin e Vladimir Kristos kanë aplikuar në Kuvend plotë 19 kandidatë. Në këtë listë të gjatë bien në sy një sërë emrash të njohur për publikun si: Çlirim Gjata, Denar Biba, Ilir Panda, Kristaq Traja, apo edhe ish-kryetarja e Gjykatës së Lartë Shpresa Bečaj dhe ish-kryeprokurori, Theodhori Sollaku. Ndërkohë për vendin e mbetur vakant nga largimi i Fatos Lulos kanë aplikuar 7 kandidatë, mes të cilëve bie sërisht në sy emri i Theodhori Sollakut dhe ai i Ilir Pandës. Pak ditë më parë Kuvendi mbyllti edhe procesin e aplikimit për vendin e mbetur vakant pas shkarkimit të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja. Për këtë vend aplikuan vetëm tre kandidatë dhe konkretisht Avni Shehu, ish-drejtoresha e



INSTITUCIONET
Në Kuvend, Presidencë dhe në Gjykatë të Lartë janë bërë plot 55 aplikime për 6 vende në Gjykatën Kushtetuese, ndërkohe që për tre vendet e tjera ose nuk është hap procesi i aplikimit ose ka dështuar për mungesë të kandidatëve. Duhet thënë se shumë prej kandidatëve kanë aplikuar disa herë për vende vakante të ndryshme.

Ligji, ja si zgjidhen anëtarët e Kushtetueses

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës. Gjyqtari nuk duhet të ketë



mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe

zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj, në mënyrë që të garantojë vazhdimësinë e saj. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

Kodifikimit të Ministrinë e Drejtësisë, Marsida Xhaferllari dhe sërisht ish-kryeprokurori, Theodhori Sollaku. Ndërkohë që edhe Presidenti i Republikës, Ilir Meta ka përmbyllur procesin për dy vakanca të tjera dhe ka dorëzuar në KED emrat që kanë aplikuar. Kështu, për vendin e lënë vakant pas largimit të Sokol Berberit kanë aplikuar plotë 20 juristë e gjyqtarë, një pjesë e mirë janë emra që kanë aplikuar

edhe në pozicionet që ka shpallur Kuvendi. Edhe në këtë listë bie në sy sërisht emri i Theodhori Sollakut, Denar Bibës, Ilir Pandës, Kristaq Trajës, Gëzim Allaraj, Ilir Mustafajit si dhe emri i Rovena Gashit. Kuvendi ka mbyllur procesin e aplikimit edhe për vendin e Altina Xhoxhaj, për të cilin kanë shfaqur interes vetëm 3 kandidatë dhe më konkretisht Prel Martini, Sinana Tafaj dhe Ardita Buna Alsula. Ndërkohë që

Presidenti i Republikës duhet të shpallë edhe kandidatët për vendin vakant të lënë nga largimi i gjyqtarit Besnik Imeraj. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë, nga 3 vende që i takojnë në Gjykatë Kushtetuese ka mbyllur procesin vetëm për një vend, atë që aktualisht e mban Vitore Tusha. Për pozicionin e Vitore Tushës kanë aplikuar në Gjykatën e Lartë në 2017, tre kandidatë: Medi Bici, Ardian Dvorani dhe Luan Hasneziri.

KANDIDATËT	
Për vendin e Sokol Berberit kanë aplikuar te Presidenti i Republikës:	
■	ALBAN BRATI
■	AVNI SHEHU
■	BESNIK MUÇI
■	DEDE KASNECI
■	DENAR BIBA
■	GËZIM ALLARAJ
■	ILIR MUSTAJ
■	ILIR PANDA
■	KRISTAQ TRAJA
■	LUAN DERVISHI
■	PETRIT KAJA
■	REXHEP BEKTESHI
■	THEODHORI SOLLAKU
■	VLADIMIR GËRMENJI
■	ARDITA ALSULA
■	ELSA TOSKA
■	REGLETA PANAJOTI
■	ROVENA GASHI
■	VALBONA BALA
■	ZHAKLINA PETO
Për vendin e Altina Xhoxhaj kanë aplikuar te Presidenti:	
■	PREL MARTINI
■	SINANA TAFAJ
■	ARDITA BUNA ALSULA
Presidenti ka shpallur procedurën për zëvendësimin e Besnik Imerajit në 07.02.2018	
Për vendin e Vladimir Kristos kanë aplikuar në Kuvend:	
■	ANILA KRISTANI
■	ARTA VORPSI
■	BESNIK MUÇI
■	ÇLIRIM GJATA
■	DASHAMIR KORE
■	DEDE KASNECI
■	DENAR BIBA
■	ELSA TOSKA
■	GËZIM ALLARAJ
■	ILIR KADIU
■	ILIR PANDA
■	IRENA NINO KAZHANXHI
■	KRISTAQ TRAJA
■	REXHEP BEKTESHI
■	SINAN TAFAJ
■	SOKOL HASANI
■	SHPRESA BEÇAJ
■	THEODHORI SOLLAKU
■	VALBONA BALA
Për vendin e Fatos Lulos i shpallur nga Kuvendi në 28.08.2018	
■	ILIR PANDA
■	SINAN TAFAJ
■	THEODHORI SALLAKU
■	VASIL BENDO
■	ELSA TOSKA
■	FIONA PAPAJOJGJI
■	VALBONA BALA
Për vendin e Bashkim Dedjas i shpallur nga Kuvendi në 24.12.2018	
■	AVNI SHEHU
■	MARSIDA XHAFERLLARI
■	THEODHORI SOLLAKU
Për pozicionin e Vitore Tushës kanë aplikuar në Gjykatën e Lartë:	
■	MEDI BICI
■	ARDIAN DVORANI
■	LUAN HASNEZIRI
Për vendin e Fatmir Hoxhës dhe Gani Dizdarit, Gjykata e Lartë s'ka shpallur ende kandidatët	

SKANDALI NE KAVAJE FSHEHJA E KRIMIT

Detajet horrort, si u detyrua 13-vjeçarja të heshtë

Burg 7 adoleshentëve që përdhunuan të miturën

Shpallet në kërkim një 15 vjeçar për të njëjtën akuzë

Gjykata e Durrësit lëshoi burg 7 adoleshentëve të arrestuar të shtunën për abuzimin seksual në grup, me një të mitur 13-vjeçare në shkollën "Rilindja" në Kavajë. Ata akuzohen për veprën penale "marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur". Të gjithë djemtë e lënë në burg kanë lindur mes viteve 2002-2004. Po kështu në kërkim është shpallur dhe një 15-vjeçar bashkëpunëtor në aktin e tmerrshëm. Disa nxënës të shkollës "Rilindja" në Kavajë kanë raportuar për JOQ detaje tronditëse. Sipas tyre, përdhunuesit e vajzës nuk kanë qenë 8, por 16 persona. E sipas tyre 14 janë nxënës të shkollës "Rilindja", ndërsa 2 të tjerë janë gjimnazistë.

KËRCËNIMI

Sipas detajeve paraprake, vajza e mitur ka qenë në lidhje dashurie me një nga djemtë. Shokët e tij kanë xhiruar video nga qëndrimi mes dy të miturve dhe e kanë kërcënuar vajzën se nëse nuk bën me ata seks, video e saj do të publikohej në rrjetet sociale dhe do i dorëzohej prindërve. E frikësuar e nën presion mësohet se 13 vjeçarja është detyruar të bëjë seks që nga muaji nëntor më të paktën 8 adoleshentë, njëri prej të cilëve është në arrati, ndërsa 7 të tjerët në burg. Babai i vajzës ka zbuluar gjithç-



Foto ilustruese

DENONCIMI

Disa nxënës të shkollës "Rilindja" në Kavajë kanë raportuar për JOQ detaje tronditëse. Sipas tyre, përdhunuesit e vajzës nuk kanë qenë 8, por 16 persona. Mësohet se 14 nga ata janë nxënës të shkollës "Rilindja", ndërsa 2 të tjerë janë gjimnazistë.

ka dhe ka denoncuar në polici, ndërsa krimi u mbajt i fshehtë nga policia. Ishte një mesazh i ardhur te qytetari dixhital i ish-

kryeministrit Sali Berisha, që bëri të mundur daljen në pah të krimin të tmerrshëm. **STATUSI I BERISHËS**
Përdhunohet nxënësja,

fshihet krimi!

Ndaj përdhunuesve nuk merret asnjë masë, anëtarësohen në FRESSH-in kanabistë.

Lexoni mesazhet e qytetarëve dixhital! sb

Doktor përhëndetje. Jam një zonjë nga Kavaja. Dua të denoncoj mënyrën flagrante se si drejton sot ZA e Kavajës zonja Sonila Peza. Prej 2 muajsh në shkollën 9-vjeçare "Rilindja" 8 nxënës të asaj shkolle kanë përdhunuar një vajzë. ZA dhe drejtoresha e saj nuk kanë marrë asnjë masë për

këtë skandal. Kemi frikë të çojmë fëmijët në shkollë. Këto janë drejtoreshat e shkollave të rilindjes. Ju lutem, publikojeni.

Përhëndetje doktor Berisha. Në shkollën 9-vjeçare "Rilindja" Kavajë përpara 1 muaji u përdhunua nga një grup prej 8 djemsh një vajzë 13-vjeçare. Kjo ngjarje është mbajtur e fshehte nga të gjithë instancat. E gjithë qyteti e di. Respekto. Ju lutem, anonim pasi ju e dini shumë mirë se çfarë ndodh më pas.

Tragjedi në liqenin e Shkodrës, përmbysët varka, vdesin katër persona

Një varkë është përmbytur dje në liqenin e Shkodrës si pasojë e një stuhie të fuqishme, duke lënë të paktën 4 viktime. Media malazeze "Vijesti" raporton se në mes të viktimave ndodhet një familje me tre anëtarë nga Zeta e Malit të Zi dhe një djalë nga Podgorica. Ndërkohë buri me nga policia për "BalkanWeb" bëjnë me dije se ngjarja në fjalë ka ndodhur në ujërat e liqenit të Shkodrës, të cilat administrohen nga shteti fqinj. Sipas dëshimve paraprake, janë mbytur fillimisht një burrë e grua së bashku me vajzën e tyre dhe një djalë që u përpoq t'i shpëtonte. Varka kishte 9 persona, 5 prej të cilëve arritën të dilnin në breg, duke i shpëtuar në këtë mënyrë tragjedisë. Drejtori i Parkut Kombëtar të Malit të Zi, Nenad Ivanoviq, konfirmoi për "Vijesti" se momentalisht vetëm një trup është gjetur, ndërkohë po kërkohet për personat e tjerë. Departamenti i Emergjencave, përfshirë edhe një helikopter ndodhen në vendin e ngjarjes, ku po punojnë për gjetjen e personave të tjerë.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

SUPPLY WITH FUEL FOR AIRSIDE VEHICLES FUEL STATION
TIRANAINTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for supply with fuel for airside vehicles, fuel station, for a period of two year with possibility of renewal.

The company needs to have the respective license for fuel supply, and also be equipped with it's own tanker, that will deliver the fuel to Tirana International Airport fuel station.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: apalushi@tirana-airport.com; fvjoka@tirana-airport.com; ialimema@tirana-airport.com specifying request for information for "Supply with Fuel for Airside Vehicles Fuel Station".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'SUPPLY WITH FUEL FOR AIRSIDE VEHICLES FUEL STATION FOR TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT'.

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Procurement Department
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs on 7 February 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all the following addresses:
apalushi@tirana-airport.com
fvjoka@tirana-airport.com
ialimema@tirana-airport.com



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje pajisje kanlecarie, letër format A4 dhe bojë për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 8,500,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkrahimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje pajisje kanlecarie, letër format A4 dhe bojë për printera, për nevojat e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oftera duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **25 Shkurt 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

RAPORTI/ Alokimi të bëhet direkt nga Tatimet dhe Doganat, të rritet në 25%

"Bashkitë nuk e marrin të plotë rentën, shkak burokracia e mosnjohja e ligjit"

Hajnaj: Nevojiten ndryshime ligjore

Procedurat burokratike, por edhe njohja e pakët e legjislacionit nga ana e njësive të qeverisjes vendore si dhe disa herë neglizhenca e drejtorive lokale të tatimeve kanë bërë që bashkitë të hasin vështirësi në vjeljen e pjesës që u takon nga renta minerare, duke humbur ndër vite shumë fonde të vlefshme për investime komunitare". Në këtë përfundim arrin raporti mbi monitorimin e përdorimit të rentës minerare në dobi të komunitetit, i hartuar nga Qendra Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim (anëtare e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, EITT), përmes një projekti të financuar nga Lëvizja Albania. Monitorimi u realizua në Bashkitë e Bulqizës, Hasit, Patosit, Roskovecit, Urës Vajgurorë dhe pati në fokus detyrimin e zbatimit të ligjit "Për Taksat Kombëtare" dhe udhëzimeve përkatëse, në bazë të të cilëve përcaktohet se 5% e rentës minerare, duhet të shkojë për bashkitë ku ushtrojnë aktivitetin kompanitë e industrisë nxjerrëse. Monitorimi u realizua përgjatë një periudhe 6-mujore, duke analizuar edhe të gjithë kuadrin ligjor që rregullon këtë fushë. "Gjithashtu, ne realizuam dhe një sondazh që kishte për qëllim matjen e perceptimit qytetar mbi njohuritë e banorëve të bashkive për rentën minerare, ndërsa më pas u bë monitorimi i bashkive përmes të dhënave zyrtare, takimeve dhe intervistave me krerët e bashkive dhe punonjësit e tatimeve në këto njësi të qeverisjes vendore", thotë Anila Hajnaj, drejtore ekzekutive e Qendrës, duke shtuar se gjatë monitorimit u zhvilluan dhe takime me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të Tatimeve, Drejtorinë e Financave Vendore të Ministrisë së Financave etj.

RAPORTI
Pas përpunimit të të dhënave, raporti konstaton se për shkak të mosnjohjes të plotë të ligjit, bashkitë nuk kryejnë procedurat e plota për rakordimin e shifrave të rentës së mbledhur nga të gjitha institucionet qendrore apo rajonale të doganave apo tatimeve. Sipas legjislacionit në fuqi, ky është një proces i detyrueshëm në mënyrë që të lindë e drejta e përfutimit, ndërkohë që ka dhe nga zyrat përkatëse tatimore apo doganore që nuk kryejnë asnjë veprim nëse bashkitë nuk bëjnë rakordimin për shitjet e brendshme apo eksportet. "Gjithashtu, edhe Ministria e Financave nuk kryen asnjë transaksion financiar për të alokuar rentën përkatëse në buxhetin e bashkive sipas kontributit, nëse nuk konfirmohet informacioni nëpërmjet formularëve 8 nga bashkitë dhe 9 nga zyrat tatimore apo doganore", shtohet në raport. Nga ana tjetër, rezultoni se ekziston një infrastrukturë e ngarkuar, e shpërndarë në shumë institucione kombëtare e vendore, e cila e ka bërë të vështirë mënyrën e



RENTA E PËRFITUAR SIPAS VITEVE DERI NË NËNTOR 2018 NË LEKË.

Bashkia	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018 deri nëntor
Has	-	-	-	913,761	91,297/3,196	277,357/263,957	9,537
Roskovec	4,247,600	9,450,806	11,176,557	48,763,316	38,556,377	42,118,348	24,982,104
Patos	16,062,400	35,738,000	42,437,874	58,919,392	43,525,958	49,610,650	41,505.16
Bulqize	-	-	-	9,202,554	24,504,592	22,675,118	14,098,567
Ura Vajgurorë	-	-	-	66,267	136,353	61,038	6,477

përlogaritjes së rentës, mblledhjes dhe shpërndarjes së saj sipas ligjit. "Koha minimale e zgjatjes së procedurave është 4 muaj nga fillimi i rakordimeve deri në alokimin e rentës në buxhetin e bashkive. Ndërkohë që të gjitha institucionet e përfshira në proces kanë zvarritje, duke neglizhuar në zbatimin e afatave të procedurave", thuhet ndër të tjera në dokument. Ndërkaq, një tjetër problematikë që haset ka të bëjë me shpenzimin e fondeve që arrijn në alokohen, duke qenë se sipas legjislacionit në fuqi, ato duhet të shpenzohen për projekte që lidhen drejtpërdrejt me komunitetin. "Renta minerare, duke u alokuar brenda buxhetit të bashkive si pjesë e taksave vendore pa u veqar dhe kushtëzuar, shkrihet dhe nuk mund të identifikohet se ku është investuar", thotë Hajnaj. "U nënvizua nga të gjithë, që sasia e rentës 5%, që duhet të rikthehet sipas ligjit nuk është aspak e mjaftueshme në raport me dëmet që pëson komuniteti nga shfrytëzimi i burimeve të tyre natyrore", shton ajo.

NDRYSHIME NË LIGJ
"Ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit është një nga problemet kryesore, me të cilin përballen aktorët gjatë procedurave të rakordimit për përfutimin e rentës minerare", thuhet në raportin e monitorimit. Gjithashtu, sipas dokumentit, problem përbën dhe numri i madh i institucioneve të përfshira në këtë proces, padija e bashkive përkatëse për t'u përshatur kërkesave ligjore dhe reale të rakordimeve si dhe pamundësia e administratës tatimore dhe doganore, për t'u përgjigjur në kohë detyrimeve ligjore dhe afateve të përcaktuara. "Këto probleme, dhe të tjera si këto, e bëjnë të nevojshëm rishikimin e kuadrin ligjor dhe gjetjen e instrumenteve efektive për ta lehtësuar procesin nga barra e madhe burokratike", shprehet Hajnaj. Në një plan afatshkurtër raporti rekomandon që brenda sistemit të transferës së rentës (95% për shtetin dhe 5% për bashkinë), alokimi të bëhet që në momentin fillestar kur bëhen transaksionet financiare të kompanive gjatë shitjeve të brendshme tek ta

timet apo eksporteve tek doganat. "Kjo do të sillte një ulje të ndjeshme të procedurave burokratike", shpjegon Hajnaj. Ndërkohë që, rekomandohet "gjetja e instrumenteve efektive për ta lehtësuar procesin nga barra e madhe burokratike si dhe rishikimi i rritjes së rentës nga 5%, në minimalisht 25%". Ndërkaq, në drejtim të transparencës dhe informimit publik, kërkohet që të gjitha bashkitë të publikojnë në shifra dhe informojnë qytetarët e tyre për rentën e mbledhur dhe projektet e investuara me të. Gjithashtu, "bashkitë duhet të përcaktojnë projektet prioritare që do të investohen me rentën e mbledhur, në bashkëpunim me komunitetin dhe shoqërinë civile". Ndërkohë që, të gjithë institucionet përkatëse si: të gjitha bashkitë ku shfrytëzohen burimet natyrore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë apo Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore duhet të publikojnë informacion të hollësishëm për rentën minerare, qëllimin dhe shpërndarjen e saj në faqet e tyre online.

NDRYSHIMET NE LIGJ
"Ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit është një nga problemet kryesore, me të cilin përballen aktorët gjatë procedurave të rakordimit për përfutimin e rentës minerare", thuhet në raportin e monitorimit. Gjithashtu, sipas dokumentit, problem përbën dhe numri i madh i institucioneve të përfshira në këtë proces, padija e bashkive përkatëse për t'u përshatur kërkesave ligjore dhe reale të rakordimeve si dhe pamundësia e administratës tatimore dhe doganore, për t'u përgjigjur në kohë detyrimeve ligjore dhe afateve të përcaktuara.

REKOMANDIMET E RAPORTIT

Në plan afatgjatë nga 1 deri 3 vjet

Rishikimi i kuadrin ligjor dhe gjetja e instrumenteve efektive për ta lehtësuar procesin nga barra e madhe burokratike. Te shihet mundësia që brenda sistemit të transferës së rentës, të kalojë 95% për shtetin dhe 5% për bashkinë në momentin fillestar kur bëhen transaksionet financiare të kompanive gjatë shitjeve të brendshme tek tatimet apo eksporteve tek doganat. Rishikimi i rritjes së rentës nga 5% minimalisht në 25% maksimumim brenda 3 vjetëve. Rishikimi i rritjes së rentës në 100% për bashkitë që kanë kontribut shumë të vogël në rentë.

Në plan afatshkurtër, gjatë 2019

Duke qenë pala e interesuar, brenda afateve ligjore, bashkitë detyrimisht të iniciojnë procesin e rakordimeve njëkohësisht me drejtoritë qendrore dhe rajonale të tatimeve dhe doganave. Bashkitë të informohen në vazhdimësi për ndjekjen e procedurave për plotësimin dhe dërgimin në kohë të formularit 9 nga tatimet dhe doganat. Bashkitë të dërgojnë në kohë sipas afateve formularin 8 në Ministrinë e Financave dhe të interesohen për procedurat në vazhdim deri në transferimin e rentës në buxhetin e tyre. Të propozohet ndryshimi i udhëzimeve të procedurave nga bashkitë dhe shoqëria civile në Bordin e EITI-t në mënyrë që të behet rakordimi drejtpërdrejtë me Drejtoritë Qendrore të Doganave dhe Tatimeve, të cilat kanë të gjithë informacionin e duhur online në çdo kohë duke zvogëluar procedurat e zgjatura me degët rajonale. Bashkitë të interesohen dhe të informohen me të gjitha instrumentet që iu ofron ligji, si drejtpërdrejtë me kompanitë, ashtu dhe nëpërmjet AKBN-së për sasinë e prodhimit të nxjerrë nga kompanitë për të krahasuar me shitjet për përcaktimin e vlerës reale të rentës.

Në kuadër të transparencës dhe informimit publik

Të gjitha bashkitë duhet të publikojnë në shifra dhe informojnë qytetarët e tyre për rentën e mbledhur dhe projektet e investuara me të. Të gjitha bashkitë në dëgjesat publike duhet të përcaktojnë projektet prioritare që do të investohen me rentën e mbledhur, në bashkëpunim me komunitetin dhe shoqërinë civile. Të gjitha institucionet përkatëse si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, të publikojnë informacion të hollësishëm për rentën minerare, qëllimin dhe shpërndarjen e saj në faqet e tyre online.

Pritet konfirmimi nga Instituti i Shëndetit Publik për llojin e virusit

Shënohen dy viktimat e para nga gripi në spitalin e Sanatoriumit

Burimet spitalore: Kishin komplikacione të rënda në mushkëri

Që prej së premtës, kanë humbur jetën 2 persona si pasojë e komplikacioneve të rënda në mushkëri, të cilët më parë ishin prekur nga gripi, çka shkaktoi komplikacione të rënda për ta. Përkatësisht, personat e moshës 47 dhe 41 vjeç, kanë mbërritur në gjendje tepër të rëndë nga qytetit i Elbasanit me pneumoni bilaterale dhe insuficiencë gati totale të mushkërive shkaktuar nga agjentë virale gripi. Ndërkohë, Instituti i Shëndetit Publik ende nuk ka një deklaratë zyrtare apo prononcim mbi llojin e virusit që i mori jetën këtyre personave. Sipas burimeve nga Sanatoriumi, rasti i parë i vdekjes është shënuar të premtën dhe vdekja e dytë e moshës 41 vjeç ka ndodhur mëngjesin e djeshëm. Ndërkohë një tjetër burim nga ky spital tha për 'News 24' se ka patur 3 raste të rënda të referuara me pneumoni bilaterale me origjinë virale nga spitali rajonal i Elbasanit në harkun kohor të 10 ditëve të fundit. Dy prej rasteve janë të moshës nga 35-40-vjeç dhe janë vendosur në reanimacion në terapi intensive. Burime nga ky spital thonë se nuk ka ende një konfirmim se kemi të bëjmë me prekje të të sëmurëve nga virusi AH1N1 ose që njihet si gripi i derrit. Konfirmimi zyrtar pritet të bëhet nga laboratorit i ISHP-së ku janë çuar mostrat për ekzaminim. Mjekët deklarojnë po ashtu se është bërë një spostim i stinës virale nga dhjetor-janari që ka qenë vjetor e kaluara drejt muajit shkurt. Shkak për këtë mendohet të jenë bërë luhatjet e temperaturave.

REAGIMI

Shefja e reanimacionit, njëherësh mjekja Alma Cani ka folur për situatën gripale që ka mbërthyer vendin. Ajo komentoi arsyet pse njëri nga pacientët humbi jetën, duke përjashtuar mundësinë që ai të jetë prekur nga gripi AH1N1, i njohur ndryshe edhe si "gripi i derrit".

"Pacienti vuan nga një patologji kronike. Ishte në reanimacion dhe nuk mundi të mbijetonte. Sa i përket gripit ne nuk kemi konfirmim për raste me grip derri, por janë të prekur nga gripi sezonal, kryesisht pacientët që vuajnë edhe nga sëmundje të tjera, përfshi këtu moshat e treta që janë më pak rezistente ndaj këtyre viruseve. Këshilloj të bëhet vaksinimi paraprak dhe duhet të jenë në kontakt me mjekët e familjes dhe mjekët specialistë", tha ajo. Mjekja Cani sqaroi më tej të gjitha simptomat që ka gripi i sivijshtëm, masat që duhet të marrin të prekurit dhe kush janë më të rrezikuarit prej tij. Ajo shtoi se agresiviteti i virusit është më i madh sa vitet paraprake.

SIMPOTMAT

Mjekja në fjalën e saj, shpjegoi për të gjithë qytet-

rët simptomat që nuk duhen neglizhuar, pasi mund të sjellin komplikacione të rënda. "Gripi fillon me temperaturat të larta, me kollë, me sekrecione, dhimbje koke dhe kyçesh. Të gjitha këto janë simptomat paraprake. Nëse nuk trajtohet mund të kalojë edhe në komplikacione si pneumoni sidomos tek qytetarët që kanë probleme kronike. Ritheksoj duhet të jenë të kujdesshëm dhe të bëjnë vaksinim", theksoi Cani.

MASAT PARANDALUESE

"Në rast se qytetarët kanë këto simptoma duhet të marrin barna, goftë për temperaturën, goftë për kollën. Nëse për dy tre ditë gjendja nuk përmirësohet duhet t'u drejtohen mjekëve", nënvizon shefja e reanimacionit. Sipas kësaj të fundit, kategoritë më të riskuara janë moshat e tretë si dhe pacientët që vuajnë nga sëmundje kronike. "Unë e përmenda edhe më herët. Janë moshat e tretë, pacientët që vuajnë nga sëmundje kronike të mushkërive, të veshkave, të heparit me probleme hematologjike, kronike", bën me dije Cupi.

MBROJTJA NGA GRIPIT

Gripi paraqet një sëmundje akute të rrugëve të frymëmarrjes të cilën e shkakton virusi i influencës të tipit A dhe B, që zakonisht paraqitet në numër të madh ose në formë epidemie gjatë periudhës së dimrit. Në këtë periudhë të shpeshta janë edhe infeksionet me viruse të tjerë respiratorë të cilët kanë simptoma të njëjta ose

PARANDALIMI

"Në rast se qytetarët kanë këto simptoma duhet të marrin barna, goftë për temperaturën, goftë për kollën. Nëse për dy tre ditë gjendja nuk përmirësohet duhet t'u drejtohen mjekëve", nënvizon shefja e reanimacionit. Sipas kësaj të fundit, kategoritë më të riskuara janë moshat e tretë si dhe pacientët që vuajnë nga sëmundje kronike. "Unë e përmenda edhe më herët. Janë moshat e tretë, pacientët që vuajnë nga sëmundje kronike të mushkërive, të veshkave, të heparit me probleme hematologjike, kronike", bën me dije Cupi.

të ngjashme me ato të gripit. Në praktikë është e vështirë të bëhet dallimi nëse bëhet fjalë për grip ose për një ftohje të zakonshme duke u bazuar vetëm në simptomat e manifestuara dhe pa u bërë analizë laboratorike. Prandaj, pa diagnozë të sigurt këto sëmundje emërtohen "sëmundje të ngjashme me gripin" ose klasifikohen si infeksione respiratore akute (IRA). Mendohet se gjatë një viti rreth 3-5 milionë njerëz në mbarë botën sëmundjen nga forma të rënda të gripit, ndërsa 250-500 mijë prej tyre vdesin. Ekzistojnë më shumë lloje të viruseve të influencës (Tipi A, B dhe C), por për njeriun më me interes janë viruset e tipit A dhe B, sepse ato shkaktojnë sëmundje tek popullata humane. Gripi është sëmundje infektive që përhapet nga një njeri tek tjetri, kryesisht nëpërmjet pikave të vogla të cilat i shpërkasin personi i infektuar gjatë teshtitjes dhe kollitjes, ose në mënyrë të thërrthortë përmes kontaktave me sekrete (lëngje) respiratore të personit të sëmurë me të cilat janë ndotur duart e tij ose sipërfaqet me të cilat ka qenë në kon-

takt, ose me gjësendet që ka përdorur. Simptomat e sëmundjes paraqiten 1-4 ditë pas depërtimit të virusit në trupin e njeriut. Pjesa më e madhe e njerëzve mund t'ua përcjellin virusin të tjerëve 1 ditë para shfaqjes së simptomave dhe 5-7 ditë pas manifestimit të sëmundjes. Kjo do të thotë se një person mund ta përcjellë virusin edhe para se të dijë se është i infektuar. Sëmundja ka një fillim të papritur me temperaturë të lartë trupore, dhimbje koke, plogështi të përgjithshme, kapitje, dhimbje të muskujve dhe nyjeve, gjembje të fytyrës, lotim të syve dhe sekrecion nga hundët, kollë e cila në të shumtën e rasteve është kollë e thatë dhe pa sekret. Nuk është e thënë që secili person i sëmurë nga gripi të ketë të gjitha simptomat, e ndodh që një pjesë e të infektuarve sëmundjen ta kalojnë edhe pa simptoma (sipas disa studimeve rreth 20-30 % e të infektuarve mund ta tejkalojnë sëmundjen pa simptoma), ose me simptoma të një ftohjeje të lehtë.

DIAGNOZA

Për vërtetimin e diag-

210

TË VDEKUR NGA GRIPIT I DERRIT NË RAJON

Numri i të vdekurve nga gripi i derrit ka arritur deri në 210 në Ballkan dhe Itali. Sipas mjekëve, rekordin e mban Rumania me 69 të vdekur. Tëpër i lartë është edhe numri i vdekjeve në Itali që në ditët e para të shkurtit arriti në 48. Viktima janë regjistruar edhe në Kroaci, Bosnje, Greqi, Mal të Zi e Bullgari. Të prekurit janë me mijëra, thuajse në të gjitha vendet ballkanike.

nozës së gripit, me strishio merret material nga fyti dhe hunda dhe dërgohen në laborator të specializuar ku në

materialet e dërguara vërtetohet prania e virusit ose pjesëve të tij. Në një kohë kur gripi është i përhapur gjerësisht në komunitet dhe ka një vërtetim laboratorik për këtë, diagnostikimi i çdo rasti në veçanti nuk është i domosdoshëm, por diagnoza caktohet mbi bazë të shenjave dhe simptomave klinike.

TRAJTIMI

Trajtimi i gripit, njësoj si edhe ftohjes, është simptomatik, domethënë trajtohen simptomat, e jo vetëm sëmundja. Zbatohet një regjim i caktuar i higjienës dhe të ushqyerit (pushim, konsumim i sasive më të mëdha të lëngjeve, ushqim i lehtë, vitamina dhe minerale), ndërsa me rekomandim të mjekut dhe në varësi nga rëndësia e sëmundjes, mund të jepen edhe disa barna antivirale. Terapia me antibiotikë jepet vetëm në raste të infeksioneve bakteriale sekondare të cilat e përkeqësojnë rrjedhën dhe rezultatin e sëmundjes, gjegjësisht për të trajtuar ndërlikimet nga gripi, por vetëm me rekomandim nga mjeku.

MASAT E PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM

- Të evitohen tubimet dhe qëndrimet në mjedise ku qëndrojnë më shumë persona, dhe posaçërisht të evitohen kontaktet me personat e sëmurë ose të cilët kanë simptoma të sëmundjes - kolliten, teshtinë, kanë temperaturë të lartë trupore!
- Duart të lahen sa më shpesh me ujë dhe sapun dhe me mjet për dezinfektim!
- Ambienti dhe mjediset ku qëndrohet gjatë ditës të ngrohen dhe të ajrohen më shpesh!
- Rekomandohet të vishen disa shtresa me rroba, të bëhet dush me ujë të ngrohtë!
- Të konsumohen pije të ngrohta (çaj, supë), lëngje të freskëta, ujë me limon.
- Të konsumohen produkte të pasura me vitaminë dhe minerale, kryesisht fruta dhe perime të cilat janë të domosdoshme për organizmin.
- Të praktikohet një mënyrë e shëndetshme dhe të jetuarit dhe shpreh të shëndetshme, gjumë dhe pushim i mjaftueshëm, të bëhen aktivitete fizike dhe mentale për të zvogëluar nivelin e stresit.

KULTURE SPECIALE

Nga Prof. Dr. Albert
Frashëri

Cdo vit, në prag të punimeve përzgjedhëse të komisionit për çmimin Nobel, del ndonjë teoricien i lirisë dhe kritikon Kadarenë si njeri të hierarkive të regjimit "republikan"

Në 6 janar 2019 gazeta e rëndësishme italiane "La Repubblica" botoi një tregim të Ismail Kadaresë me titull:

"Unë nuk kam frikë"

Kjo javë e ditëlindjes së njeriut më të shquar të letrave dhe të botës kulturore moderne shqiptare do të kishte nevojë për botime të veçanta e të rëndësishme mbi veprën e tij. Unë po kufizohem me disa mendime rreth këtij tregimi brilant dhe afiniteteve interesante që ai shpreh me jetën e Kadaresë dhe sidomos me disa pamje të realitetit shqiptar.

Nuk është e lehtë të flasësh për një vepër të porsabotuar të një prej shkrimtarëve më të famshëm të kohës sonë. Vepra e tij shumë herë ka shprehur ide që nuk shfaqen drejt-përdrejt, por që burojnë nga veçoritë e një stili unik dhe nga mendimi i kulturuar i autorit që lexuesit e të gjitha gjuhëve kanë kuptuar pa vështirësi. Në veprën letrare të këtij prozatori të rrallë ajo që nënkuptohet e nuk shqiptohet hapur, shpesh herë është më e rëndësishme nga ajo që fjala formalisht rrëfen. Kjo cilësi dallon shkrimtarët e mëdhenj, mes të cilëve Kadareja tashmë ka merituar një nga piedestalet më të lartë.

Tregimi i Kadaresë, rrëfyer nga goja e një femije me urtësinë dhe përvojën e pafund të autorit, më sjell ndërmend prirjen dhe raportin e veçantë që Kadareja ka me botën e legjendave dhe fantazinë që ato krijojnë. Natyrisht unë nuk pretendoj të sjell pikërisht mendimin e autorit dhe idenë e tij në këtë tregim. Shpesh herë rreth një vepre artistike bëhen komente apo reagonime me konkluzione apo "zbulime" për të cilat autori as që ka menduar ndonjëherë. Kjo ndodh sepse një vepër artistike, pikturë, poezi, roman apo muzikë, bëjnë të mundur

Urtësia e Kadaresë në rrëfimin e feminisë së tij

(Kadaré, Shakespeare dhe fantazmat)



interpretime të ndryshme që pajtohen me natyrën e veprës, por që nuk përputhen gjithmonë me synimet origjinale të autorit. Prandaj për çdo devijim nga ana ime kundrejt mendimit të autorit, i kërkoj ndjesë atij dhe lexuesve.

Pra unë do të përpiqem shkurtimisht të shpjegoj idenë që kam krijuar për këtë tregim të Kadaresë.

Ky është një tregim me të cilin duket sikur autori kërkon t'i besojë lexuesit disa të vërteta që lidhen edhe me raportin e vështirë që ai ka patur dhe ka me një pjesë të papërfillshme të vendit të tij.

Me dy fjalë, tregimi "Unë nuk kam frikë" rrëfen kujtime feminare të Kadaresë në Gjirokastrën e tij. Ai flet për familje e sh-

tëpi të periudhës perandorake turke, të mbretërisë shqiptare e, më pas, edhe të republikës, shtrat i një totalitarismi të pamëshirshëm e absurd. Një humor i lehtë dhe elegant shqëron rrëfimin feminar të Kadaresë. Ai si femijë vëzhgon dhe përpiqet të kuptojë dallimet mes monarkisë, perandorisë dhe republikës, duke u nisur nga karakteristikat e

shtëpive dhe sjelljet e njerëzve që banonin në to. Në femijëve, shkruan Kadare, na pëlqenin më shumë shtëpitë e kohës së mbretërisë edhe pse ishin më të mblehdura, por në ato fitej të shumë dhe me fjalë të embla. Në shtëpitë e tjera ka heshtje dhe shpesh herë ato janë të frikshme për shkak të hajdutëve dhe fantazmave që herë pas here futen në to. Në atë periudhë, shkruan autori, hajdutët dhe fantazmat ishin kudo të

shëm, ishin mësues, avoketë, inxhinierë që republika i kishte shpallur si banditë, si agjentë anglo-amerikanë, ndërsa fantazmat ishin gënjeshtër, shpifja dhe fanatizmi. Në këtë këndvështrim femija donte të largonte fantazmat nga bota e tij.

Fëmija ishte i zhgënjyer nga republika që tregohej e ashpër me banditët dhe mike e fantazmave. Atij i vjen në ndihmë Shakespeare, inglizi i famshëm që kishte shkruar edhe për fantazmat në tragjedinë e Hamletit. Aty ai kishte mësuar që ki-ki-ri-kiii i gjelave në prag të agimit i largonte fantazmat që i trembeshin gjelit, lajmëtar i një dite të re. Por e keqja ishte që familjet e fisme nuk mbanin pula e gjela në shtëpitë e tyre. Kur iu rrëfye gjyshes për këtë merak të madh ajo i kujtoi gjelat e fqinjëve dhe ky ishte shpëtimi. Ishte ki-ki-ri-kiii i gjelave fqinjë që i largoi fantazmat nga



pranishme: hajdutë apo banditë, hije e fantazma.

Boshllëku, mediotkriteti, fanatizmi i regjimit shndërrohen në bindje dhe ide të rëndomtë që përligjin dhunën e pakufishme dhe për këtë sajohet fantazma, armiku që duhet shfarosur nga faqja e dheut. Në radio, kujton Kadare, flisnin ditë e natë për hije të krijuara nga fashizmi, nga Amerika e Izraeli. Hijë dhe fantazma. Fëmija natën kishte frikë kur dëgjonte kujtsjen, gërvimën e trarëve nën peshën e përlëshjes mes hajdutëve dhe fantazmave. Nuk dinte femija se cilin të preferonte: hajdutin apo fantazmën. Hajdutët u ngjanin njerëzve të nder-

catia e tij. Dhe ki-ki-ri-kiii i gjelave të Ficove, Xhaxhive dhe fqinjëve të tjerë u përhap kudo nga malet e Linxherisë përmes Shqipërisë, Dalmacisë, në Austri e Danimarkë deri në trojet e inglizit që mbante atë emër të çuditshëm, Shakespeare. Ishte i madhi i shkrimtarëve që kish dashur të shpëtonte njeriun nga fantazmat. "Ndërsa mendja më shkante kah Poli i Veriut, një gjumë i thellë, më i ëmbli që kisha shijuar, më mori në krahët e tij."

Komicitetin e gjelit lajmëtar dhe ki-ki-ri-kun e tij mund ta interpretojmë si lindjen e një ditë të re, si një triumf të së Vërtetës kundër fantazmave të



gënjeshtrës e të thashethemeve të pafund që aq shumë e dëmtojnë të sotmen dhe të ardhmen e një komuniteti e, ndonjëherë, edhe të një kombi. Kadareja ka shumë arsye për të kujtuar dramën e njeriut të thjeshtë e të ndershëm që bie nën hijen e fantazmave të së keqes e të gënjeshtrës, pas të cilave fshihet dhuna, padrejtësia. Por nuk është hera e parë që ai e bën këtë. Ai i ka njohur fantazmat duke filluar nga agimi i krijimtarisë së tij. Ai e ka përjetuar frikën prej tyre, e ka ndjerë pranë si asnjë tjetër në historinë e arteve dhe letërsisë të regjimit totalitar në Shqipëri. Por në këto

për mendimin tim, për shkak të disa opinioneve absurde dhe antikombëtare.

Nuk dimë si mund të deshifrohet ideja, qëllimi i këtij tregimi tipik kadarian, mes alegorisë dhe realitetit, frikës dhe fantazmave. Megjithatë ka disa koïncidenca që duhet t'i pranojmë me bindje e që na bëjnë të mundur një interpretim të këtij tregimi të jashtëzakonshëm, si art e si përmbajtje.

Tregimi i Kadaresë na lejon të bëjmë një interpretim të natyrshëm e aktual të fabulës që shpreh, të fantazmave të republikës kundër qytetarëve më të shquar të saj. Republika

që simbolizonte vetëdijen për lirinë e humbur nga regjimi totalitar i Hoxhës. Shpifjet dhe dyshimet ishin fantazmat që ndrydhën pamjen shpirtërore të kombit, talentet e tij. Me sa duket ajo, e ashtuquajtura metodologji fantazmagorike e regjimit, vazhdon të mbijetojë në mes nesh, çuditërisht e mëkuar nga shovinizmat e gadishullit të mplakur të Ilirisë. Çdo vit, në prag të punimeve përzgjedhëse të komisionit për çmimin Nobel, del ndonjë teoricien i Ilirisë dhe kritikoni Kadaresë si njeri të hierarkive të regjimit "republikan". Këtë mund ta kurdisë vetëm padituria, injoranca e atij që vihet në rolin e fantazmës kundër banditëve të sajaur. Pikërisht siç bënte Hoxha me idhtarët e tij.

Në këto tri dekadat e fundit, pranë datave historike të rëndësishme, shkruhen e botohen artikuj të rremë e të turpshëm kundër figurave të nderuara të botës shqiptare. Kjo po bëhet sistematikisht në indiferencën e fajshme të institucioneve të shtetit shqiptar. Këto që shohim e dëgjojmë janë hije e fantazma të shovinizmave ballkanike që kanë vrarë priftërinj ortodoksë pse bënin meshën në gjuhën e nënës pra në shqipë të kulluar, kanë vrarë mësues të gjuhës shqipe, kanë persekutuar e masakruar popullsinë e pafajshme të krahinës iliro-epirote vetëm pse kultivonte gjuhën shqipe. Sot me keqardhje dhe në indiferencën totale të klasës politike goditen figurat e shquara të historisë e të



kulturës kombëtare: hidhen teza absurde mbi origjinën e Gjergj Kastriotit, braktisen në harresë të fajshme figura si Naimi, Fishta, Mjeda, Migjeni, Noli deri dhe te Kadareja. Prej tre dekadash Kisha Ortodokse Autoqefale, që Noli i madh e bëri të pavarur nga fundamentalizmat orientale e shoviniste, e ka humbur sharmin e kombit që nuk e administron me duart e veta pamjen fetare e shpirtërore të jetës së tij. Noli, dua të kujtoj që, pas Naim Frashërit, vepra e Nolit dhe e Kadaresë shprehin përpjekjen gjennale të tyre për një shqipe moderne në pajtim me potencialet e jashtëzakonshme që ka kjo gjuhë. Të rinjtë shqiptarë, edhe pse të shkolluar, nuk njohin universin kulturor të kombit, nuk njohin personalitetet e shquara dhe as veprat e tyre.



Në historinë e letrave të Europës Lindore dhe të regjimeve totalitare në përgjithësi, rasti Kadarë do konsideruar me plotë bindje si unik. Asnjë artist nuk ka guxuar të shkruajë e të rrezikojë si ai nën thundrën e regjimeve totalitare. Kur lexonim "Dimrin e madh" ne kishim të qartë se si Kadarë nxirrte në pah ligësinë dhe fanatizmin ideologjik të shefit të kuadrut që bënte politikën e partisë dhe që nën peshën e mëkateve ishte shtrembëruar në formën e shkronjës Z (xeta). Kur lexonim "Pallatin e ëndrrave" ne përfytyronim Komitetin Qendror si shtabi i kobshëm i paudhësive të Hoxhës kundër kombit të tij. Asnjë shkrimtar nuk ka guxuar të bëjë atë që arriti të shkruajë e të botojë Kadareja. Ai, për mendimin tim, është i vetmi njeri i kulturës që me vetëdije të plotë ka rrezikuar e shkruar kundër regjimit me format më të rafinuara të artit që mrekullisht gjuha shqipe arrin të shprehë. Ai shkruante për Diellin dhe në nënkuptonim errësirën në të cilën bënin sikur jetonim. Këtë mund ta bëjë

vetëm një artist, qytetar patriot e demokrat i kulluar.

Nuk mund të mos kujtojmë si e trajtonte Naimi i madh problemin e Gënjeshtrës e të së Vërtetës. Filozofia e poezisë naimjane ndër të tjera theksonte nevojën e kërkimit të së Vërtetës si kusht të përparimit të individit, të familjes e të kombit. Ai e trajtoi këtë problem në vargje, me qartësi e thjeshtësi gjennale, duke shprehur parimet mbi të Vërtetën në pajtim me konceptet sokratiane, kristiane e islamike: kërkimi i të Vërtetës e çliron njeriun dhe i jep kuptim e dinjitet ekzistencës individuale e kolektive. Është mahnitëse mënyra dhe thjeshtësia me të cilën poetët e Rilindjes Kombëtare e kanë konsideruar problemin e të Vërtetës, Mirësisë, të Bukurisë dhe harmonisë e tyre të pafund si kusht themelor për shpëtimin e Njeriut, të

Njerëzimit e si thelb të demokracisë. Fenomeni i Rilindjes Kombëtare tregoi me qartësi dhe e bëri realitet këtë parim... themelor për të ardhmen e kombit.


Njerëzit më të ndritur të kombit formohen nën ndikimin e kulturës, traditave e historisë kombëtare. Nga ana tjetër ata e ndikojnë pozitivisht atë burim, d.m.th. Universin Filozofik e Kulturor të kombit. Sot, e them me keqardhje, dëgjojmë e lexojmë shprehje apo komente mbi figurat të rëndësishme të kombit që të brengosin e të revoltojnë për ligësinë dhe injorancën që shprehin duke mos kursyer as Nolin apo Nënë Terezën.

Figura si Ismail Kadarë dhe Nënë Tereza nderojnë kohën tonë në të gjitha sferat e kulturës botërore. Sot dhe në të ardhmen ato janë e do të jenë nga monumentet më të shquara të botës shqiptare.



dekadat e fundit ai ka përjetuar të tjera zhgënjime,

shpalli si banditë ajkën e saj, atë pjesë të shoqërisë



Skadoi afati i vendosur nga Europa për ish-presidentin

Maduro do të zbusë kundërshtarët, premton zgjedhje të parakohshme para mbështetësve

Presidenti i Venezuelës, Nikolas Maduro, në një mënyrë për të qetësuar kundërshtarët e tij dhe zemërimin popullor, u shpreh se do të zhvillojë zgjedhje të parakohshme për Asamblenë Nacionale. Ai foli para mbështetësve të tij në një ditë kur e gjithë Venezuela u përfshi në protesta masive kundër tij. Lideri i opozitës dhe presidenti i vetëshpallur Huan Guaido e akuzon se Maduro u zgjodh në një proces zgjedhor me manipulime të mëdha. Guaido njihet si president nga SHBA dhe disa vende të tjera, mes të cilave edhe Sh-

qipëria e Kosova. Por, nga ana tjetër, kaosi politik e ka zhjatur Venezuelën në mjerim. Ndërsa policia e kontrolluar nga Maduro po shtyp zërat kundër rezervat ushqimore dhe karburanti në Venezuelë janë drejt fundit. Opozita ka kërkuar ndihma humanitare për të cilat presidenti i vetëshpallur Huan Guaido tha se do të vijin në një jasthë, brenda pak ditësh, pavarësisht kundërshtimit të Maduros. Ndërkajq ka skaduar dje edhe ultimatumit



që vendet kryesore europiane i vendosën udhëheqësit majtist venezuelian Nikolas Maduro për mbajtjen e

zgjedhjeve të reja presidenciale. Gjermania, Franca dhe Britania e Madhe i bënë thirrje Maduros që brenda 8 ditëve të përcaktonte datën e zgjedhjeve të parakohshme. Në të kundërt ata do të zyrtarizonin njohjen e kreut të opozitës Huan Guaido si President të përkohshëm, duke nxitur po ashtu edhe Bashkimin Europian të ndërmerret këtë hap. Ultimatumin, gjithësi, Maduro e ka refuzuar që javën e kaluar, teksa

propozoi zgjedhje të parakohshme parlamentare brenda këtij viti. Në Karakas manifestimet pro dhe kundër Maduros kanë vijuar edhe gjatë së shtunës, ndërsa komandanti i divizionit të Forcave Ajrore shpalli publikisht mbështetjen për Guaidon. Në një mesazh të publikuar në Youtube, Rodrigex tha se 90% e ushtrisë janë kundër Maduros. Vendimi i tij u përshëndet në Tëitëter nga këshilltari i Trump për sigurinë kombëtare, i cili bëri thirrje për dezertim masiv të ushtrisë në mbështetje të demokracisë. Perëndimi është renditur në krah të Guaidos, ndërsa Maduro ka mbështetjen e Rusisë, Kinës e Turqisë.

11 vite pas bllokadës greke, në 6 shkurt nënshkruhet protokollin

Jens Stoltenberg: Maqedonia e Veriut bëhet pjesë e NATO

Jelko Kacin: Procedura mund të zgjasë dy vite

Jens Stoltenberg, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, ka zbuluar se në 6 shkurt do të mbahet ceremonia e nënshkrimit të dokumentit për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Aleancë. "Më 6 shkurt do të shënojmë historinë: Aleatët e NATO-s do ta nënshkruajnë protokollin për inkuadrim me Maqedoninë e Veriut së bashku me MPJ Dimitrov", shkroi Stoltenberg në Twitter. Pas ratifikimit të Marrëveshjes së Prespës në Maqedoni, e pastaj edhe në Greqi, është larguar pengesa e fundit për anëtarësimin e vendit në Aleancën Veriatlantike, gati pas 11 viteve pas bllokadës greke në Samitin e Bukureshtit, në prill të vitit 2008. Ceremonia e nënshkrimit do të mbahet në selinë e NATO-s në Bruksel, në praninë e ministrit të Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov. 29 ambasadorët e vendeve anëtare do ta nënshkruajnë protokollin, pas çka Maqedonia do të mund të marrë pjesë në të gjitha "formatet kyçe" të Këshillit veriatlantik. Siç sqaroi ambasadori sloven pranë NATO-s, Jelko Kacin, në një intervistë për MIA-n, Maqedonia nuk do të mund të marrë pjesë në mbledhjet ku shkëmbehen informacionet më të ndjeshme, derisa nuk bëhet anëtare e plotfuqishme dhe me këtë e arrin njohurinë e nevojshme për udhëheqje me atë lloj të informacioneve të ndjeshme.



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg

JENS STOLTENBERG:

"Më 6 shkurt do të shënojmë historinë: Aleatët e NATO-s do ta nënshkruajnë protokollin për inkuadrim me Maqedoninë e Veriut së bashku me MPJ Dimitrov", shkroi Stoltenberg në Twitter.

simin e Maqedonisë në fund të javës në vijimi, më 8 shkurt. Pas nënshkrimit të protokollit nga 29 vendet anëtare të Aleancës do të ngrihet flamuri i Maqedonisë të Veriut së bashku me ata të të gjithë vendeve anëtare para selisë së Aleancës në Bruksel, ndërsa përfaqësia e përhershme diplomatike e vendit do të duhet të bartet, gjithashtu, në zyrat e reja së bashku me anëtarët e tjera. Ndërkajq në fund të janarit, një lajm i mirë për Maqedoninë vjen nga Gjermania, e cila është

shprehur pozitive për pranimin e Maqedonisë në NATO. "Anëtarësimi i Maqedonisë në NATO është me rëndësi të madhe për sigurinë e hapësirës euro-atlantike si dhe impulsi i rëndësishëm për stabilizimin e mëtejme të Ballkanit Perëndimor", thuhet në njoftimin e qeverisë gjermane. Nga ana tjetër, Sekretari i Përgjithshëm i Aleancës Atlantike të Veriut, Jens Stoltenberg ka kërkuar nga 29 vendet anëtare të nënshkruajnë protokollin e anëtarësimit. Stoltenberg,

JELKO KACIN:

"Maqedonia nuk do të mund të marrë pjesë në mbledhjet ku shkëmbehen informacionet më të ndjeshme, derisa nuk bëhet anëtare e plotfuqishme dhe me këtë e arrin njohurinë e nevojshme për udhëheqje me atë lloj të informacioneve të ndjeshme", - ka thënë ambasadori sloven pranë NATO.

Rrëfhet Gruevski: Mora informacione se do më eliminonin

Ish-Kryeministri maqedonas Gruevski, ka theksuar se ika qenë i gatshëm të shkojë të vuajë dënimin me burg, por siç tha, ka pasur njoftime të sigurta brenda burgut se përgatitet eliminimi i tij, duke mos dhënë detaje të hollësishme rreth këtyre njoftimeve. "Mora informacione se kush qëndron pas këtij komploti, sepse nuk mund të ofroja prova për këtë gjë në atë moment. Prandaj, vendosa të largohesha nga Maqedonia", tha ai. LSDM-ja i është përgjigjur deklaratës së ish-Kryeministrit Nikolla Gruevski, i cili deklaroi se një ditë do të marrë fund "persekutimi i tij politik" në Hungari dhe do të mund të kthehet në Maqedoni. LSDM-ja vlerëson se Gruevski mund të kthehet në Maqedoni, por vetëm në burg. "Maqedonia do të ketë një karrige në NATO, ndërsa frikacak dhe i arratisuri nga drejtësia Nikola Gruevski po pret për vendin e tij në një qeli. Suksesi i Republikës së Maqedonisë është disfatë më e madhe e tij". Gruevski ka mohuar se ka pasur ndihmë nga autoritetet hungareze, kryesisht nga Kryeministri Orban. Thotë se ka vizita të shumta nga miq dhe bashkëpartiaqë të tij, por është shprehur i zhgënjyer nga disa ish-ministra të kabinetit të tij, për të cilët ka thënë se "miqtë e mirë njihen në kohë të vështira".

tha se pasi 29 vendet të ratifikojnë protokollin, do të mund t'i urojnë Maqedonisë së Veriut mirëseardhje si anëtarja e 30-të. Gjithashtu, edhe Bullgaria dha dritë jeshile për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO.

SHKURT

Gjermani, Angela Merkel mbyll 'Facebook'-un

Mbyllja e Facebook' erdhi përmes një videoje të postuar në median sociale. Aty Angela Merkel deklaroi, se "ju e dini, që nuk jam më kryetare e partisë CDU, dhe prandaj do ta mbyll faqen time të 'Facebookut'". Në Dhjetor Merkelin e zëvendësoi Sekretarja e Përgjithshme, Annegret Kramp-Karrenbauer. Në të njëjtën kohë Merkel falënderoi ndjekësit e saj në Facebook për "mbështetjen e madhe". Megjithatë ju mund të vazhdoni ta ndjekin punën time si kancelare, tha Merkel. Për këtë është përgjegjëse faqja e qeverisë gjermane në Facebook'. Mbështetësit mund të më ndjekin edhe në Instagram, u shpreh Kancelarja. Më shumë se 2.5 milionë vetë e kishin klikuar me "pëlqim" faqen e Kancelares Merkel, që kishte lënë kështu pas presidentin Macron, i cili ka vetëm 2.3 milionë ndjekës në Facebook', apo kryeministren Theresa May me 503.000 ndjekës.

Armamenti i ri i Rusisë tërheq vëmendjen e armikut

Ushtria ruse është pajisur me një armim të ri jo vdekjeprurës, por që shpërqendron armikun. Arma e re është instaluar deri më tani në dy fregata ruse. Arma e quajtur "5P-42 Filin" është projektuar për të neutralizuar përkohësisht armikun. Kjo armë, pasi neutralizon kundërshtarët, shkaktton disa efekte që bllokon aftësitë e ushtarëve, duke e bërë të pamundur shikimin gjatë natës. Kjo është testuar në një rreze prej 2 kilometrash. Të gjithë ushtarët që përdornin armë të tilla si snajper; pushkë dhe armë automatike, ishin vërbuar dhe e kishin të pamundur të shikonin objektivin. Gjatë testeve të kryera, 45% e vullmetarëve thanë se kishin pësuar të vjella për shkak të efekteve nga kjo armë e re. Ndërsa 20% të tjerë pësuan halucinacione. Dy fregata të tjera ruse pritet që të pajisen me këtë armim.

Australi, videoja fut në telashe futbollistin


Një video e bërë publike në rrjetet sociale, duket se i ka shkaktuar telashe futbollistit të kampionatit australian, Jack Watts. Ky i fundit shfaqet në një video amatore duke konsumuar një substancë narkotike nga gjoksi i një gruaje. Besohet se kjo ngjarje ka ndodhur në muajin Tetor gjatë festimeve të "Oktoberfest", apo festës së birrës. Menaxheri i futbollit i hodhi poshtë çdo pretendim se pluhuri i bardhë që duket në video të jetë kokainë. Ai tha se bëhet fjalë për një substancë ligjore që përdoret gjerësisht në Gjermani gjatë "Oktoberfest". Menaxheri deklaroi se ky pluhur quhet "Wiesn Pulver", një substancë përbërë nga mentoli, sheqeri dhe gluukoza.

MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Si të eliminoni
dhimbjet e kyçeve
dhe kockave
me hithër

KESHILLA



Ushqimet
që duhet të
konsumoni për një
kujtesë të fortë

Çenkuela Hasa:



◆ Blogerja healthy lifestyle: Si të përmirësoni sistemin kardiovaskular e kolesterolin

Këshilla për një stil jete të shëndetshëm

"Regjimi ushqimor që duhet të ndiqni për një trup të bukur"

• Problemet me tensionin e lartë, sa kafe duhet të pini

Blogerja healthy lifestyle: Si të përmirësoni sistemin kardiovaskular e kolesterolin

Çenkuela Hasa:

Këshilla për një stil jete të shëndetshëm

"Regjimi ushqimor që duhet të ndiqni për një trup të bukur"

Voltiza Duro

Vrulli i jetës së përditshme, bën që shpesh herë të konsumojmë ushqime të shpejta fast-food, apo të mos kryejmë aktivitetin fizik që i nevojitet trupit. Kjo mënyrë jetese shkakton jo pak problematika në organizëm. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", Çenkuela Hasa; blogere për healthy lifestyle, tregon sekretet për një jetesë të shëndetshme dhe regjimin që duhet të mbajmë. Më tej ajo jep disa këshilla praktike për të hequr kilogramet e tepërt e për të pasur një trup të bukur. Hasa shton se vetëm nga një shëtitje, e alternuar me vrap në natyrë, mund të përmirësohet sistemi kardiovaskular, frymëmarrja, kolesterolin, dhe dhjamosja e organeve.

Si lindi ideja për të patur një blog?

Të kesh një blog personal do të thotë që të duhet të ndash gjërat e tua shumë personale për një fushë të caktuar. Filllova të ndryshoj stil jete dhe pashë të vetja ndryshime fantastike, të cilat nuk mund të rrija pa i shpërndarë me miqtë e mi. Kështu vendosa të flas më shumë, nëpërmjet fotove motivuese, recetave, etj. Thjesht, çdo ditë, ndaja ato që bëja.

Ç'do të thotë të kesh një stil të shëndetshëm jete?

Të kesh një stil, të mos mbash diçka për një periudhë kohe, për të patur linja të bukura, por të kesh një mënyrë jetese, ku në çdo zgjedhje, t'i tregon kujdes për shëndetin. Të jesh

përzgjedhës kur bën pazaret; të gatuash në mënyrën e duhur; të mos e lësh trupin e uritur, por t'i japësh ato ushqime që ai realisht ka nevojë; të hash, aq sa i duhet organizmit tënd dhe mos e tepro-

miellit integral, makaronave, quinoas dhe tërshërës që është shumë e shëndetshme për organizmin dhe e pasur me fibra. Nuk duhet harruar për të pirë sa më shumë ujë për të qenë të hidratuar.

Si mund të kemi një trup të bukur?

Kjo është pyetja që më bëhet çdo ditë, në fakt. Unë mendoj që çdo fizik është i bukur, nëse ne vendosim ta vëmë në dukje. Nga çdo fizik mund të merret maksimumi i gjeneve tona. Në fillim, të pranojmë veten dhe mos krahasohemi. Ky është hapi parë i parë; të pranojmë veten dhe të punojmë për ta përmirësuar. Dy janë rrugët kryesore: ushqimi i duhur dhe aktiviteti fizik. Alternimi i të dyjave do t'ju mbajë gjithmonë në formë. Por çdo gjë



sh. Një stil i shëndetshëm, ndërkohë, nuk ka kuptim pa aktivitet fizik.

Çfarë ushqimesh sugjeron që duhet të jenë patjetër në regjimin tonë? Janë shumë, por perimet të gatuar në mënyrë "al dente", për t'i ruajtur vlerat duhet t'i konsumojmë çdo ditë. Nga ana tjetër, nuk duhen lënë mënjanë frutat, ushqimet me proteina si: veza, qumështi, peshku, gjiza, etj. Pastaj vijnë fibrat dhe karbohidrate, të cilat i marrim nëpërmjet orizit,



do kohën e duhur dhe durim, që shpesh mungon te njerëzit me të cilët komunikoj. Kjo është arsyeja kryesore, se përse, disa ia dalin dhe



Çenkuela Hasa

disa, jo.

Sa orë aktivitet duhen në ditë?

Kjo varet nga shumë faktorë dhe në këtë rast, nuk shkon shprehja, "sa më shumë, aq më mirë." Një atlet stërvitet shumë më shumë se një njeri i zakonshëm. Jo të gjithë kanë shumë kohë të lirë, për shkak të angazhimeve në punë dhe familje, por ky nuk është justifikim. Për të qenë në formë, brenda dhe jashtë, të gjithë mund të gjejnë një orë të lirë në ditë. Duhet theksuar se, përfitimet janë të shumta edhe nga ana shëndetësore dhe shpirtërore. Vetëm nga një shëtitje, e alternuar me vrap në natyrë, mund të përmirësohet sistemi kardiovaskular, frymëmarrja, kolesterolin, dhjamosja organeve dhe çlrohemi nga

Nga komunikimet që ke me ndjekësit, cilat janë gabimet që bëjnë më shpesh me ushqimin?

Hanë rrallë dhe shumë. Nuk konsumojnë mëngjes duke menduar që kjo do t'i ndihmojë të jenë më në formë, ndërkohë që mëngjesi duhet të jetë i bollshëm, i pasur me fibra dhe proteina, për t'i dhënë trupit energjinë e duhur për të vazhduar ditën. Konsumojnë darkën në orët e vona; një traditë shqiptare, që vazhdon ende sot. Janë shumë të dhënë pas bukës apo brumërave, në përgjithësi. Gatuhen në mënyrë tradicionale, me shumë vaj; perimet konsumohen rrallë, apo dhe kur i gatuajnë në formën e gjellës, i zhveshin nga çdo vlerë ushqimore. Byreku dhe ushqimi i shpejtë përdoret nga të rinjtë çdo ditë, si zgjedhja më e shpejtë, por një copë e vogël byreku ka një çmenduri kalorish. Kjo nuk do të thotë që unë nuk ha asnjëherë byrek, por nuk është pjesë e stilit tim të jetesës. Këto gjëra duken si pa rëndësi, por, në fakt, janë shkak për të gjitha sëmundjet që vijnë më pas.

Mesazhi juaj për ata që nuk kanë akoma motivimin e duhur për të filluar?

Investimi për trupin dhe shëndetin tuaj është gjëja më e mirë që mund të bëni. Asnjëherë nuk është vonë për të filluar! Çfarë konsumoni ju në një ditë dhe cila do ishte dita ideale? Një ditë e shëndetshme është ajo që ka balancë midis makro-nutrienëve; pra, ditë e pasur me fibra, proteina, karbohidrate dhe drithëra. Më poshtë po ju jap një shembull: Mëngjesi: 1 gotë qumësht, omllet me vezë, një fetë buke integrale. Paradreaka: një frut Dreaka: perime të ziera, fileto pule, ose peshku. Paradarka: fruta të thata Darka: disa perime në avull dhe një copë djathë, pa kripë.

Voltiza Duro

Hithrat janë një bimë me dicinale shumë të shëndetshme për organizmin e njeriut. Ato përmbajnë mbi 50 përbërës kimike e kanë shumë efekte pozitive në trup pasi e ndihmojnë në stimulimin e sistemit limfatik dhe prandaj përmirësojnë imunitetin. Këshillohen të përdoren të njoma ose të thata nga individët që janë anemikë dhe të dobët, apo që preken shpesh nga gripi. Mund të përdoren në gjellë dhe të gatohen njësoj si spinaqi, ose në byrek, duke u përzier edhe me spinaq. Kur ziejnë hithrat e humbasin djegien që shkaktojnë kur janë të njoma, kështu që nuk ka problem në përdorimin në gatim. Kjo bimë gjithashtu ndihmon në uljen e tensionit, zgjerimin e venave dhe arterieve dhe hollon gjakun. Hithra ka një rol të rëndësishëm në ruajtjen e një zemre të shëndetshme e nëse përdoret rregullisht parandalon sëmundjet e zemrës.

Hithrat ndihmojnë tretjen dhe largojnë parazitët në zorrë e, gjithashtu, parandalojnë simptomat e menopauzës, dhe zbutin dhimbjet e menstruacioneve. Vlen të theksohet se përmbajnë shumë minerale, prandaj këshillohet të përdoren nga individët mbi 45 vjeç, pasi janë shumë të ushqyeshme për kockat, por ndihmojnë edhe në parandalimin e kancerit të prostatës. Nëse jeni duke përdorur hollues gjaku apo nëse keni tension të ulët mund t'i përdorni me sasi të vogla hithrat. Nëse keni tensionin e lartë, keni yndyra në gjak apo varicë këshillohen të përdoren rregullisht në verë kur mund t'i gjeni të njoma, dhe gjatë dimrit 1 deri në 3 muaj si çaj, në muajt e ftohtë për ushqimin e kockave dhe largimin e reumatizmit. Hithrat ndihmojnë edhe në uljen e sheqerit në gjak e janë ushqyeshme shumë mirë i kockave pasi përmbajnë shumë minerale dhe vitamina dhe ushqejnë kockën. Këshillohen të përdoren për të luftuar osteoporozën dhe reumatizmin. Hithrat ndihmojnë në largimin e dhimbjes së kyçeve dhe kockave. Nëse keni dhimbje të forta të gjunjëve mund të shpëtoni hithrat, t'i përzieni me kripë të zezë dhe të mbështillni gjurin gjatë gjithë natës. Mund ta përsëritni për 3-4 net me radhë, dhe dhimbjet e kyçeve do të ndalojnë. Lëngu i hithrave përmban gjithë këto vitamina dhe minerale dhe shkon deri në kocka.



Mjeku popullor: Përbërësit kimikë të bimës forcojnë imunitetin dhe largojnë parazitët

Ylli Merja: Si të eliminoni dhimbjet e kyçeve dhe kockave me hithër

"Përzierja e mrekullueshme për një zemër të shëndetshme"



Mjeku popullor
Ylli Merja

Përbërësit

Hithrat e njoma dhe të thata kanë përbërës të ndryshëm por gjatë tharjes bima i humb disa nga përbërësit aktivë. Në hithrat e njoma ndodhen flavonoide me shumicë, të cilat janë në sasi më të vogla në hithrat e thatë. Flavonoidet janë antioksidantë që ndodhen tek shumë bimë dhe fruta, dhe ndihmojnë në pastrimin e organizmit nga toksinat, ulin rrezikun për shumë sëmundje si kanceri etj. Gjenden beta karotenoide

si beta-karoten, të cilat ndihmojnë në forcimin e sistemit imunitar dhe në përmirësimin e shikimit. Hithrat e njoma përmbajnë vitamina si: A, C, D, E, F, K, P, and B-komplekse, gjithashtu, thiamin, riboflavin, niacin, and vitamin B-6, të gjitha janë në nivele të larta antioksidantësh. Përmbajnë rreth 16 aminoacide, të cilat ndihmojnë në rigjenerimin e qelizave në organizëm. Gjethet e thara janë analizuar për përmbajtjen ushqyeshë, janë të pasura me vitaminë E, vitamina B2, hekur, zink, kalcium, etj. Hithrat e thara e humbasin vitaminën C dhe beta-karotenin, por përmbajnë të 16 aminoacidet dhe përbërësit e tjerë.

Receta

Kjo përzierje mund të përdoret përpara ushtrimeve fizike, apo përpara se të shkoni në palestër. Ky lëng frutash i shëndetshëm për zemrën dhe trurin ka këta përbërës: 2 lugë kos; 10gram gjethe hithra të njoma; 10 gram spinaq; 1 kivi; 1 mollë; 20 gram lakër të kuqe; pak akull dhe 1 lugë me fara chia. Futen të gjitha në mikser dhe përzihen derisa të bëhet masë e njëtrajtshme. Në fund shtohen 3-4 thelpinj arre dhe përzihen përsëri në mikser.



Këshilla



Ushqimet që duhet të konsumoni për një kujtesë të fortë

Problemet me kujtesën janë gjithnjë e në rritje me kalimin e moshës.

Ato ndikohen dhe nxiten nga problemet me gjumin, stresin, depresioni, mungesa e vitaminës B, tiroidja, alkoli, duhanpirja dhe ilaçet.

Në raste më të rënda, kujtesa e varfër nxitet edhe nga skleroza apo sëmundja e Alzheimerit. Sëmundjet e rënda të kujtesës, kërkojnë trajtim të specializuar mjekësor dhe jo thjesht kura natyrale që mund të përgatiten në shtëpi.

Bajamet

Bajamet përmirësojnë kujtesën dhe fuqinë e trurit. Ato janë të pasura me antioksidantë dhe acide yndyrore Omega-3, të cilat janë fantastike për kujtesën dhe për shëndetin e syve. Zhysni 5-10 bajame në ujë dhe të nesërmen griji në mikser pa lëkurë. Masën e përfutur ziejeni duke e bashkuar me një gotë qumësht. Shtoni mjalte dhe pijeni çdo ditë për 30-40 ditë.

Rozmarina

Kjo bimë fantastike është ideale për kujtesën dhe për trurin. Ziejeni një tufë rozmarinë në ujë për pesë minuta. Kullojeni lëngun dhe shtoni mjalte. Pijeni çdo ditë për 3-4 javë. Ju mund të përdorni edhe

vaj esencial rozmarine duke e nuhatur çdo ditë.

Vaji i peshkut

Suplementët me vaj peshku përmirësojnë kujtesën dhe funksionet e trurit. Acidet yndyrore tek vaji i peshkut parandalojnë formimin e pllakave të trurit që kanë lidhje me sëmundjen e Alzheimerit. Merrni 600 mg vaj peshku çdo ditë. Ushqehuni rregullisht sa të keni mundësi me salmon, sardele, harengë dhe skumbri.

Frutat e pyllit

Frutat e pyllit, siç janë boronicat, qershitë dhe manaferrat janë një burim i shkëlqyer flavonoidësh që përmirësojnë funksionin e trurit dhe kujtesën. Konsumojini ato rregullisht që të merrni vlerat më të mira.

Ndër ushqimet e tjera më të mira për shëndetin e trurit, janë avokado, panxhari, lëngu i kockave të mishit, brokoli, selinoja, vaji i arrës së kokosit dhe çokolata e zezë.



Problemet me tensionin e lartë, sa kafe duhet të pini

Njerëzit që vuajnë nga tensioni i lartë i gjakut duhet të tregojnë kujdes me kafën sepse ajo mund të rrisë rrezikun e atakut në zemër. Një studim italian analizozi të dhënat e 1,200 personave nga moshja 18 deri në 45 vjeç. Ekspertët përmbledhën dhe analizuan të dhënat mjekësore në një hark kohor prej 12 viteve. Pjesëmarrësit në studim kishin një tension sistolik të gjakut që varioonte nga 40 deri në 159 mm/Hg dhe një tension diastolik që varioonte nga 90 deri në 99 mm/Hg. Në harkun kohor të 12 viteve, ekspertët vunë re rreth 60 raste problemesh shëndetësore me qarkullimin dhe zemrën. Në 80 përqind të rasteve, njerëzit përjetuan një atak në zemër ndërsa të tjerët u përballën me ishemi, probleme me veshkat dhe probleme me qarkullimin e gjakut. Sipas ekspertëve, njerëzit që pinë shumë kafe në ditë janë 4 herë më të rrezikuar nga problemet e lartpërmendura. Njerëzit që pinë sasi mesatare të kafesë janë 3 herë më të rrezikuar nga këto probleme.

Sasia mesatare e kafesë i referohet 1 deri në 3 pijeve me kafeinë në ditë. Sasia e lartë ditore e kafesë i referohet 3-4 ose më shumë filxhanëve kafe në ditë. Studimi kishte si objektiv të gjente lidhjen mes pirjes së kafesë, tensionit të lartë dhe atakut në zemër, por jo të zbulonte shkakun dhe pasojën. Ekspertët paralajmëruan se njerëzit që kanë probleme me tensionin duhet të kufizojnë sasinë ditore të kafesë dhe nënprodukteve të tij. Kafeja, thanë studiuesit, rrit rrezikun e fazës së parë të diabetit që i çel udhën plotësisht diabetit të tipit 2. Kjo u vu re tek disa pjesëmarrës, duke përfshirë edhe rolin genetik dhe faktorë të tjerë si mbipeshja. Ekspertët inkurajojnë një qasje më të shëndetshme ndaj ushqimit, aktivitetit fizik dhe konsumit të kafesë. Sipas tyre, një sasi e shëndetshme e kafesë për njerëzit që vuajnë nga tensioni i lartë është më pak se 3 filxhanë në ditë.

Kush do të testohet në pozicionin infermier, fizioterapist, mami e teknik laborator

Voltiza Duro

Të gjithë ata që kanë aplikuar për një vend pune në portalin "Infermierë për Shqipërinë", tashmë mund të njihen me pikët që kanë mundur të grumbullojnë. 'Gazeta Shqiptare' publikon sot listat e fituesve për Qarkun e Tiranës si dhe datat e testimi të kandidatëve që kanë kaluar fazën e parë. Përkatësisht janë 357 fitues në këtë qark për Infermierinë; 81 fitues për pozicionin mami; 57 fitues në Teknik Imazherie; 80 fitues për pozicionin Teknik Laboratori; dhe 89 fitues në Fizioterapi. "Testimi do të bëhet në Godinën e Lëndëve Paraklinike (pas spitalit infektiv) Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, për të gjithë për të gjitha qarqet", thekson Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Zbardhen emrat e 664 fituesve që aplikuan në 'Infermierë për Shqipërinë'

Kalendari me datat e provimit në fazën e dytë

DATAT DHE ORARI SIPAS QARQVE DHE PROFILEVE:

- Qarku Shkodër, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Tiranë, Qarku Durrës dhe Qarku Dibër profili Infermieri datë 9 shkurt 2019, ora 12.00.
- Qarku Elbasan, Qarku Korçë, Qarku Berat, Qarku Fier, Qarku Vlorë dhe Qarku Gjirokastrë profili Infermieri datë 10 shkurt 2019, ora 12.00.
- Qarku Shkodër, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Tiranë, Qarku Durrës dhe Qarku Dibër profilet Mami, Teknik laborator, Teknik imazherie, Fizioterapist datë 16 shkurt, ora 12.00.
- Qarku Elbasan, Qarku Korçë, Qarku Berat, Qarku Fier, Qarku Vlorë dhe Qarku Gjirokastrë profilet Mami, Teknik laborator, Teknik imazherie, Fizioterapist datë 17 shkurt, ora 12.00.

(vijon nga nr. i djeshëm)

45	Malvina	Strazimiri	Tiranë	Tek-Imazheri	7
46	Dervish	Vrapi	Tiranë	Tek-Imazheri	7
47	Mikela	Haska	Tiranë	Tek-Imazheri	7
48	Orjada	Todhe	Tiranë	Tek-Imazheri	6.1
49	Frederik	Pjetraj	Tiranë	Tek-Imazheri	5.9
50	Elda	Dervishi	Tiranë	Tek-Imazheri	9
51	Andi	Koci	Tiranë	Tek-Imazheri	6.6
52	Mereme	Caca	Tiranë	Tek-Imazheri	9.8
53	Entela	Gjoni	Tiranë	Tek-Imazheri	9
54	Bukurije	Halili	Tiranë	Tek-Imazheri	10.7
55	Besmira	Berdufi	Tiranë	Tek-Imazheri	10.7
56	Fjoralba	Koxhaj	Tiranë	Tek-Imazheri	8
57	Enxhi	Sulce	Tiranë	Tek-Imazheri	6.5

Qarku Tiranë Teknikë laborator

Nr	Emer	Mbiemer	Qarku	Profesioni	Piket nga dosja
1	Adelina	Daci	Tiranë	tek-laboratori	7
2	Adlind	Coma	Tiranë	tek-laboratori	10.5
3	Anila	Berboti	Tiranë	tek-laboratori	10.7
4	Alda	Shehi	Tiranë	tek-laboratori	12.8
5	Alteo	Pula	Tiranë	tek-laboratori	6.5
6	Andela	Vaska	Tiranë	tek-laboratori	6.5
7	Anisa	Zaclli	Tiranë	tek-laboratori	10.8
8	Anjeza	Lushllari	Tiranë	tek-laboratori	10
9	Anxhejana	Alinani	Tiranë	tek-laboratori	10.1
10	Aurora	Cana	Tiranë	tek-laboratori	10.6
11	Besjana	Gjeloshi	Tiranë	tek-laboratori	8.6
12	Besmira	Docë	Tiranë	tek-laboratori	13.2
13	Blerta	Budani	Tiranë	tek-laboratori	10.7
14	Borana	Kalemaj	Tiranë	tek-laboratori	11
15	Daniela	Doce	Tiranë	tek-laboratori	14.3
16	Donika	Duka	Tiranë	tek-laboratori	8.5
17	Dorina	Kristja	Tiranë	tek-laboratori	15
18	Dorjan	Calliku	Tiranë	tek-laboratori	9.3
19	Drita	Struga	Tiranë	tek-laboratori	7.4
20	Elda	Kapllani	Tiranë	tek-laboratori	8.5
21	Eljona	Reci	Tiranë	tek-laboratori	9.3
22	Emila	Dika	Tiranë	tek-laboratori	10.4
23	Enkeleda	Bracja	Tiranë	tek-laboratori	9.5
24	Enkeleda	Hoxha	Tiranë	tek-laboratori	6.7

25	Eriselda	Disha	Tiranë	tek-laboratori	7.1
26	Erjon	Sinani	Tiranë	tek-laboratori	6.9
27	Ermal	Manci	Tiranë	tek-laboratori	6.6
28	Ersunela	Keli	Tiranë	tek-laboratori	8.4
29	Eva	Shametaj	Tiranë	tek-laboratori	6.5
30	Evisa	Ranxha	Tiranë	tek-laboratori	8.2
31	Fjoralba	Bane	Tiranë	tek-laboratori	11.2
32	Florian	Ibrahimi	Tiranë	tek-laboratori	7.8
33	Geraldina	Galo	Tiranë	tek-laboratori	10.2
34	Gerta	Carku	Tiranë	tek-laboratori	10.1
35	Ilda	Cela	Tiranë	tek-laboratori	9.2
36	Ina	Hysenllari	Tiranë	tek-laboratori	9.2
37	Ivana	Kristo	Tiranë	tek-laboratori	7.2
38	Joniada	Xhaferaj	Tiranë	tek-laboratori	6.5
39	Klejvi	Avdij	Tiranë	tek-laboratori	11.3
40	Klemena	Rrodhe	Tiranë	tek-laboratori	9.4
41	Kliinti	Kallajxhiu	Tiranë	tek-laboratori	8.4
42	Klodjana	Ibra	Tiranë	tek-laboratori	7.1
43	Kristjana	Pashaj	Tiranë	tek-laboratori	8.7
44	Ledina	Vatoci	Tiranë	tek-laboratori	9.9
45	Lira	Toli	Tiranë	tek-laboratori	8.1
46	Maria	Merkuri	Tiranë	tek-laboratori	10
47	Marsela	Kanaci	Tiranë	tek-laboratori	9.9
48	Matilda	Qemalli	Tiranë	tek-laboratori	6.6
49	Megi	Xibraku	Tiranë	tek-laboratori	10.2
50	Miranda	Ramku	Tiranë	tek-laboratori	5.2
51	Mirela	Shguni	Tiranë	tek-laboratori	7
52	Nera	Kapo	Tiranë	tek-laboratori	9.5
53	Nevila	Malaj	Tiranë	tek-laboratori	11.5
54	Nina	Abazi	Tiranë	tek-laboratori	9
55	Olian	Beti	Tiranë	tek-laboratori	6.9
56	Olian	Beti	Tiranë	tek-laboratori	6.8
57	Orjada	Todhe	Tiranë	tek-laboratori	6.1
58	Ornela	Keci	Tiranë	tek-laboratori	10.3
59	Pranvera	Arra	Tiranë	tek-laboratori	17
60	Raul	Mucollari	Tiranë	tek-laboratori	10.9
61	Rexhina	Haxhiu	Tiranë	tek-laboratori	7
62	Serxho	Koci	Tiranë	tek-laboratori	6.2
63	Sidorela	Maja	Tiranë	tek-laboratori	7
64	Suela	Karriqi	Tiranë	tek-laboratori	11
65	Vjodi	Dekovi	Tiranë	tek-laboratori	10
66	Xhensila	Qemalaj	Tiranë	tek-laboratori	9.4
67	Xhovana	Kocoli	Tiranë	tek-laboratori	7.1
68	Xhuliana	Cakalli	Tiranë	tek-laboratori	7.1
69	Armena	Lame	Tiranë	tek-laboratori	7.4
70	Eriola	Kabashi	Tiranë	tek-laboratori	11.2
71	Kalica	Xhori	Tiranë	tek-laboratori	14.6
72	Antrita	Piku	Tiranë	tek-laboratori	16.4
73	Mirjeta	Jashari	Tiranë	tek-laboratori	6.3
74	Mariglenda	Shrezi	Tiranë	tek-laboratori	9.1
75	Mirela	Hajdarmataj	Tiranë	tek-laboratori	9
76	Fjoralba	Zela	Tiranë	tek-laboratori	10.1
77	Joniada	Malaj	Tiranë	tek-laboratori	10
78	Bora	Nazarko	Tiranë	tek-laboratori	7
79	Aida	Gjini	Tiranë	tek-laboratori	8.7
80	Griselda	Kubazi	Tiranë	tek-laboratori	11

EKSPOZITA

Nga Artan Shabani*

"L'eterno femminino", femra në artin pamor

Nga 4 shkurti deri më 30 prill në
Rezidencën Italiane në Tiranë

Më një valle dëfruese, pa marrun frymë" vjen sot "L'eterno femminino". Dhe njëmend shfaqet kjo ekspozitë kushtuar figurës së femrës, ku nga nëna tek vajza, nga aksionistja tek inovatorja, nga modelet në studi-ot artistike tek shoqja e jetës, gjejmë të pasqyruar në letër imazhin e saj, nga skicat e thjeshta e deri tek emërtesa buçitëse e dheut tonë me emrin "Nënë Shqipëri". Latinët e quanin Mater Matuta, gjallëruese e jetës, Nëna e madhe, e cila konsiderohej Perëndesha e pjellorisë. Këto pamje i shikojmë të derdhura në ritmin e historisë dhe të jetës sonë, ritëm ky që vjen i pazburuar në secilën vepër, "me harmoni vijash të bindshme", nga më romantiket gjer tek ato më të përligjura nga ngarkesa e ideologjisë së kohës; nga portretet më zbiruese gjer të lëkura e trupave të vizatuar deri në poren e fundit të dëshirës. Gjithçka ngelet e fortë si era kundërmuese e vajit të linit në velaturat e fundit të portretit femëror, vaj mbi pëlhurë i vendosur diku në dhomën-studio, mbathur nga aroma tipike e tubetave "Mussini". Ekspozita "L'eterno femminino" bën bashkë autorë të brezave të ndryshme të artit shqiptar të nëntëqintës, që nga fillimet, periudha e vetzolimimit e deri të shprehjet bashkëkohore të ditëve tona. Në këtë "valle dëfruese" paraqiten vepra në pikturë, skulpturë, fotografi, vizatime etj. Imazhi femëror është një vijimësi e krejt artit pamor; lëvruar prej artistëve të dy gjinive. Femra ngelet ndër subjektet më të trajtuara dhe më të ngarkuara me domethënie simbolike të të gjitha kohërave. Mënyrat e paraqitjes së figurës së saj kanë ndikuar "variablin e tharmit artistik" mbi të, duke ndjekur hap pas hapi zhvillimin e teknikave artistike, ndryshimin e shijave estetike dhe përthyerjet etike të lëvizjeve të ndryshme të artit si dhe, element jo më pak i rëndësishëm, ndryshimin e mënyrës së konceptimit të rolit të gruas në shoqëri.

Veprat e para me subjekte femërore i gjejmë tek Pjetër Marubi, Ndoc Martini, Kol Idromeno, Simon Rrota, Zef Kolombi, Spiro Xega, Sofia Zengo, Androniqi Antoniu etj. "Motra Tone" (1883) mbetet emblematike për trajtimin të portretit të femrës shqiptare, në pikturë, plot bukuri dhe hijeshi, një punim i përkorë i mjeshtrit Idromeno, i cili, përtej pikturës, la gjurmë edhe si arkitekt, urbanist, fotograf dhe skenograf. Ky artist e bën atë figurë një ndër veprat e para dhe më domethënëse të pikturës laike shqiptare. Jo më pak të arrira janë portretet, nudot, kompozimet e figurave femërore, realizuar nga artistët e tjerë të asaj periudhe si Andrea Kushi, Vangjush Mio, Janaq Paço, Kristina Koljaka, etj. Këta autorë mbeten të rëndësishëm për artin e pjesës së parë të nëntëqintës shqiptare edhe për frymën europiane që i dhanë atij në Shqipëri, meqenëse ishin formuar kryesisht në akademitë e Romës, Firences, Athinës. Veprat e tyre janë më së shumti figura njerëzore, portrete, paisazhe, natyra të qeta, etj. dhe meritojnë studime të veçanta për tem-



L'eterno femminino

La rappresentazione della donna nell'arte albanese dal novecento a oggi

Dal novecento ad oggi

L'Ambasciatore d'Italia in Albania, Alberto Cuttito
Ha l'onore di invitare

all'inaugurazione della Mostra di artisti albanesi
"L'eterno femminino" a cura di Artan Shabani

che avrà luogo il 4 febbraio 2019 alle ore 18,30
presso la Residenza d'Italia (Rr. e Elbasanit, nr. 2, Tirana)

Cena buffet a seguire.

atikat e trajtuara dhe për rëndësinë e kohës që dëshmojnë. Në ditët e sotme ato bëjnë pjesë të trashëgimisë të patjetrueshme kulturore të vendit tonë.

MEDITIM MBI EKSPOZITËN

Nisur nga këndvështrimi kohor, në ekspozitën "L'eterno femminino" gjejmë një vepër të pikturuar në vitin 1925, vaj mbi kanavacë, nga Simon Rrota, ku shfaqet figura e gruas malësore me veshjen tipike tradicionale, plot kolorit të spikatur. "Zadrimerja" vjen e ngrohtë dhe plot dritë, ashtu si ishte edhe vetë natyra e artistit. Shpeshherë në tablotë e tij mjeshtri Rrota shfaqet i tërhequr nga figura e femrës së trevave të Veriut, kompozuar e veshur me kostumin karakteristik të zonave të Nën-Shkodrës dhe të Malësisë së Madhe. Elementi femëror dhe kostumet tipike, si pjesë e pandarë e imazhit kolektiv të gruas, zënë një vend qëndror në krijimtarinë e autorit. Veprat e Simon Rrotës janë pjesë e fondit të Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura, ish-Galeria Kombëtare e Arteve në Tiranë. Po ashtu ato gjenden edhe në disa koleksione private, si në atë të koleksionistit Kozma Dashi, i cili i ruan me një përkushtim fanatik. Falë pasionit të koleksion-

istëve, u bë e mundur që veprat e Rrotës të ishin pjesë e ekspozitës "Visione di confini" dhe "L'eterno femminino", në hapësirat e Rezidencës Italiane në Tiranë.

Me mjaft interes është portreti laps mbi letër i Sofia Zengo Papadhimitri, përfaqësuese e denjë e grupit të artistëve të traditës. Ndihmëse e zellshme e të atit, Vangjelit, edhe ai piktor, dhe nxënëse e talentuar e mjeshtrit Vangjush Mio, Sofia së bashku me motrën, Androniqi, të dyja të diplomuara në Akademinë e Arteve të Athinës, lanë një trashëgimi të pasur dhe përkujtohen si piktorët e para profesioniste në historinë e artit pamor shqiptar. Vepra e pranisht një portret femre, që mbart gjurmët e një kohe të largët, e cila shpesh troket akoma me tharmin e saj.

Një surprizë jo e paktë është prania e portretit femëror realizuar në vaj nga poeti-piktor Lasgush Poradeci. Qetësia dhe uniciteti i vepërës së Poradecit, portret i një dashnie të pathënë, na intrigon pafund. Punuar në stilin impresionist, portreti mahnit veçanërisht me shprehjen e zhirimit të syve, si ato të një Madone të destinuara të heshtë me lotët e gjakosur si stigma kujtesë! Brenda asaj

shprehjeje mund të shohim imtësisht, një botë disi të panjohur, "ashtu dhe akordi i heshtjes frytin e ambël të marrveshtjes", dhe kjo e bën edhe më intriguese këtë vepër të rrallë nga një artist po aq i rrallë.

Në artin e realizmit socialist që mbizotëron pas viteve '60 hasim tre elementë bazë. I pari është ai i dëshmorëve të luftës, ku një pjesë të veçantë i kushtohet heronjve dhe

Sali Shijakut, që mban në dorë si trofe kokën e pushtuesit - sulltan, një ndër veprat më të fuqishme që trajtojnë figurën e femrës luftarake; "Shqipëria vallzon" e Abdurrahman Buzës, ikonë e pikturës shqiptare, ku shpaloset harmonia dhe moderniteti i tablosë, mjeshhtërisht të arrirë nga piktori; "Vajzat me biçikleta" e Vilson Kiliçës që ngelet padyshim një nga veprat më të pëlqyera nga të gjithë artëdashësit për ngjyrat e saj; një shpërthim i vërtetë i talentit të autorit; artistë të tjerë të rëndësishëm si Fuat Dushku, Dh. Gogolari, Andrea Mano dhe Perikli Çuli me monumentin "Katër heronjave të Mirëditës"; Niko Progni me "Lajmet e mëngjesit"; Agim Fajme me "Gratë e fshatit tonë"; Jakup Keraj me "Mjelësja"; Dhimitraq

Trebička me "Pas qitjes"; Skënder Kamberi me "Buka e duarve tona"; Agim Shami me "Orizoret" etj. Nuk mund të mos përmendim këtu skulptorët si Kristina Koljaka, Shaban Hadëri apo Hilmi Kasëmi me veprën "Pritja", apo Muntaz Dhrami, Kristaq Rama, Thoma Thoma, që me krijimtarinë e tyre i kanë dhënë një hov të jashtëzakonshëm zhvillimit dhe pasurimit të artit shqiptar.

Në ekspozitën "L'eterno femminino" arti i realizmit socialist përfaqësohet nga vepra si "Duhet të fitojmë", e Robert Përmetit, një pikturë ku të rrëmben kompozimi i vajzave dhe energjia e tyre rinore; portretet dhe kompozimet e Fatbardha Shkupit, nga përshëndetja e aksionistëve tek figura e



heroineve, që ende sot i gjejmë në shumë qendra të banuara; i dyti procesi i ndërtimit të socializmit, me prioritet rolet e luajtura nga femra; i treti mbrojtja e atdheut, si detyrë mbi detyrat. Në shtypin dhe revistat e kohës, ashtu si tek parrullat në hapësirat e ndryshme publike, gjejmë intensitet të personalizuar propagandistik dhe riprodhim të shumëfishuar imazhesh ikonografike: nga skulpturat e shesheve, te posterat e Kinostudios dhe pllakatet unike të Safo Markos, Pandi Meles, Ibrahim Çezmës, Shyqyri Sakos, Ksenofon Dilos etj. Asaj kohe ekspozoheshin vepra me dimensione muzeore të artistëve Fatmir Haxhiu, Çlirim Ceka, Hasan Nallbani, Bashkim Ahmeti etj. me përmbajtje sipërfaqe objektesh, të trajtuara në funksion "pop-art socialist".

Ia vlen të përmendim disa nga veprat më përfaqësuese të asaj periudhe, të ngulitura tashmë në kujtesën kolektive, si: "Demonstrata e bukës" e Skënder Kamberit, ku femrat protestojnë kundër zisë së urisë dhe përleshen një për një me burrat; "Heroinat Persefoni Kokëdhima dhe Bule Naipi" të Piktorit të Popullit Guri Madhi; "Nëna shqiptare" e Lec Shkrelit, që lufton kundër pushtuesve osmanë; "Tornitorja" e Zef Shoshit, zgjedhur nga kuratori Adam Szymczyk për Muzeun Kombëtar të Artit Bashkëkohor në Athinë, përgjatë "Documenta 14"; "Vajza me shpatë" e

vajzës me grykësen e shkollës; skulptura në dyll "Penelope" e Arben Bajos, trajtuar me shumë ndjeshmëri dhe plot karakter për qëndrimin e gjetur të vajzës, që e bën ndër punimet më të pëlqyera; përkushtimi artistik i Qazim Kër-tushës, i cili shkruhet bashkë me veprën e tij të quajtur "Pjelloria", qëndrimi i lartë mjeshtror i Janaq Paços me portretet femërore, të cilat mbartin dëshminë e kohës për thyerjet e pjesës së trupave nudo nga vetë artistit, aspekt ky që do të meritonte ndoshta një studim të plotë dhe një ekspozitë më vete. Një tjetër artist i kësaj periudhe, ekspozuar në Muzeun Kombëtar të Artit Bashkëkohor dhe në Muzeun Benaki të Athinës, është Pandi Mele. Këtu paraqitur me një portret femre, e cila mban një bukë rumbullake në duart e saj plot muskuj. Trajtimi i ngrohtë dhe ngjyrat në tempera dhe pastel e bëjnë atë një vepër shumë intime. Fuqia mjeshtrërore e artistit Guri Madhi me "Ujitëset", ku figurat e femrave marshojnë me vrullin revolucionar që shpjen ujën e jetës, duken si një imazh bibliik. Freskia koloristike e punimeve të Jozita Shkrelit vjen me një harmoni kromatike tipike të kostumografisë shqiptare. Veshje të traditës trajton edhe piktura e Qamil Pzren-it, që sjell natyrshëm femrën shqiptare plot nur dhe hijeshi. Kujdesi dhe shija e hollë e pikturës së Skënder Milorit mbizotëron →

Opinion *i* Ditës

Nga Aida Cama

(vijon nga faqja 1)

...Nënskretarja e Përgjithshme e OKB, thotë se shpëtimi i hebrenjve nga shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore, "mishëron principet e Deklaratës Universale së të Drejtave të Njeriut". Njohja e këtij kapitulli të historisë së Holokaustit, atij të shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri, është i rëndësishëm për dhënien e shembujve pozitivë, në një kohë kur populizmi, ksenofobia, neonazizmi dhe grupet që nxisin urrejtjen janë në rritje. "Të kuptosh rëndësinë e veprave historike të kryera në mbrojtje të të drejtave të njeriut, si ajo në Shqipëri, është hapi i parë për inkurajimin e mënyrës pozitive të të sjellurit mes njerëzve në ditët e sotme", thotë Smale, shefe e komunikimit në OKB.

Aktiviteti i organizuar nga Misioni i Përhershëm i Shqipërisë pranë OKB dhe Kongresi Botëror i Hebrenjve mbledhi anëtarë të organizatave joqeveritare, përfaqësues shqiptarë të feve në SHBA, përfaqësues të komunitetit hebre, diplomatë dhe anëtarë të diasporës shqiptare.

"Unë jam krenarë të nderoj sot trashëgiminë shqiptare dhe të jem pjesë e një kombi, që qëndroi në krahun e duhur të historisë, në momentin e duhur, dhe mori vendimin e duhur", thotë ambasadorja e Shqipërisë pranë OKB, Besiana Kadare, e cila tregoi faktet historike të shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri.

Heshtja është krim
Ambasadori Rondal Laudere,

Të gjithë sot kemi nevojë për besën!



president i Kongresit botëror hebre, vlerësoi komunitetin hebre në Shqipëri "që është krenar jo vetëm si komunitet hebre, por edhe si komunitet shqiptar", si dhe qëndrimin prohebre të qeverisë shqiptare. Ai vlerësoi kurajën e shqiptarëve dhe aftësinë drejtuese, në një kohë kur "të gjithë të tjerët dëgjonin çfarë u thoshin ata që kishin mbi krye". Ambasadori Laudere vërejt rritjen e antisemitizmit dhe vakumin e lidershit në botë. Ai e quan indiferencën dhe mosvlerësimin njëjtë si krimi dhe heshtjen të rrezikshme. "Nazistët bënë krimin më të madh në botë, por pjesa tjetër e botës bashkëpunoi nëpërmjet heshtjes".

Histori të hebrenjve në Shqipëri

Çfarë do të thotë të jesh hebre dhe të kesh shpëtuar në Shqipëri e tregon Anna Kohen, e lindur në Shqipëri në një familje hebreje që gjeti shpëtim në Vlorë. "Ishte një kulturë e tërë në Shqipëri, që i bëri rezistencë Holokaustit dhe shpëtoi të gjithë hebrenjtë", thotë ajo dhe bën thirrje të mos paragjykojë grupe të tëra njerëzish, por të shohësh individin dhe ta respektosh atë.

Majlinda Myrto tregoi historinë e familjes së saj, në shpëtimin e dy hebrenjve dhe punën që bën fondacioni që ajo drejton Eye Contact në dokumentimin e shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri.

Robert Singer, nga Kongresi botëror i hebrenjve, thotë se botës i duhet besa, i duhet një busull morali. "Botës i duhet një kod moral që t'i shohë të huajt si mysafir, në çdo vend të saj."

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



Opinioni *i* Ditës

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

Rritemi katër herë dhe prapë duam të ikim!



...pak ditë më parë. Si ekonomist duhet të gëzohem dhe provoj ta bëj këtë. Mirëpo, kur dëgjoj tam-tamet se në vitin 2013 këta që kemi sot në pushtet e morën ekonominë tonë me 1 për qind rritje (është plotësisht e saktë) dhe tani, 6 vite më vonë, është 4.2 për qind rritja (pra katër herë më shumë, prapë saktë), nuk di pse nuk arrij dot të ndihem më mirë. Madje ase edhe të ngrohem sadopak. Thjesht, nuk di pse më kujtohet Ali Komiku (ish-ministri irakian i Informacionit që në konferenca shtypi deklaronte çdo ditë shpartallimin e trupave amerikane dhe fitoren e afërt të regjimit të Sadam Huseinit, ndërkohë që trupat amerikane ishin duke mbërritur në Bagdad). Kërko ndjesë për krahasimin (i cili politikisht nuk ka ku të qëndrojë), por çdo ditë pyes veten: çfarë ka që nuk shkoi me këtë ekonominë tonë? Jemi rritur katër herë në 6 vjet! Krejtësisht e vërtetë. Pra, një bum i mirë-filltë! Rritja më e madhe në rajon. Me një rritje të tillë ekonomike çdokush do të donte të jetonte këtu tek ne. Mirëpo, pse 6 nga dhjetë prej nesh duan të ikin nga shteti këmbët larg Shqipërisë? Këtë raport i fundit i FMN-së nuk e thotë (dhe, në fakt, nuk është detyrë e tij). Mos vallë thjesht pse emigracioni ekonomik këtë ka (kështu ikin edhe polakët dhe rumunët nga vendet e tyre, që janë anëtarë të Bashkimit Evropian)? Mos vallë pse edhe shqiptarët gjejnë kontrata më të mira pune në vendet e tjera të BE-së, si polakët dhe rumunët? Po të ishte kështu, edhe në Poloni dhe Rumani ata që do të donin t'i largoheshin atdheut duhet të ishin 50 e 60 për qind e popullatës, si tek ne. Në fakt, janë vetëm përkatesisht 18 dhe 26 për qind. Tek ne aplikojnë për lotarinë amerikane edhe sipërmarrës të suksesshëm, që kanë krijuar aq të ardhura dhe pasuri ndër vite, për të rritur pa kokëçarje jo vetëm fëmijët e tyre, por edhe nipërit. Megjithatë duan të ikin, jo se morën në SHBA një kontratë pune më të mirë, por se këtu nuk kanë sigurinë për të ardhmen e fëmijëve të tyre dhe se mundësitë për një vijim të mbarë të sipërmarrjes (për të garuar pastër në një tender publik, për shembull) ua kazeruar një ekonomi shtetërore e bllokuar nga oligarkët tanë. Kur sipërmarrës me emër duan të largohen dhe aplikojnë për vizë amerikane, ç'mund të themi për intelektualët e këtij vendi? E ku mund ta shohin ata të ardhmen për fëmijët e tyre, përveçse jashtë shtetit? Ky është realiteti ynë i hidhur, jashtë ditirambeve të qefllive të shifrave. Rritja jonë ekonomike nuk do të na ngrohte edhe po të kishite qenë dyfish, 8 për qind! Dhe a e dini pse? Sepse nuk përkthehet në mijëra vende pune të reja. Është rrenë me bisht se mbi çerek milioni shqiptarë (262 mijë vetë) janë punësuar pas vitit 2014. Shumica punonin në të errët dhe kanë dalë në dritë (njinhen nga shteti, pse tani e tutje u paguhen

sigurimet shoqërore). Po të ishte se do të kishim kaq vende pune të reja të krijuara në këto pesë vitet e fundit, shifra e 45 për qind të shqiptarëve që në vitin 2015 donin t'i largoheshin vendit, sipas organizatës mbledhëse opinionesh Barometri i Ballkanit, duhej të ishte ulur të paktën nën 40 për qind, dhe jo të shkonte 60 për qind, sa rezultoi në vitin 2017. Ja pse çdokush që kërkoi të mburret me shifrat për ekonominë tonë të sotme në ditë të hallit, më kujton Ali Komiku. Ja pse mesatarja 4.2 për qind e rritjes ekonomike është e gënjeshtërt, kur mëton të na thotë se çdo shqiptar që jeton në Shqipëri duhet të ndjehet në 1 janar 2019 4.2 për qind më i pasur se sa në 1 janar 2018. Nuk është e vërtetë. Mesatarja gënjen! Janë shumica, ndoshta dy të tretat e shqiptarëve që ndihen më të varfëruar se sa më 1 janar 2018 (dikush më shumë e dikush

më pak). Ndërsa po, 5 për qind e tyre janë 4 për qind më të pasur (ndërkohë 0.1 për qind e popullsisë, oligarkët tanë ndihen 11-12 për qind më mirë). Por këto shifra askush nuk i nxjerr me studime të thelluara, ose të përpiqet t'i nxjerrë. Vetëm institucionet ndërkombëtare flasin për pabarazinë sociale të thelluar tek ne. Dhe mes kësaj pabarazie ulëritëse çfarë bëri qeveria në tetor 2018 kur përgatiti buxhetin e të gjithë shqiptarëve? Zengjinëve tanë të kompanive aksionere në paketën fiskale (të taksave) për vitin 2019 të buxhetit të shtetit, ua uli dividendin (shpërndarjen e fitimit të kompanive aksionere) shtati përgjysmë (47%). Pse paguanin shumë këta zengjinë me rrogat që u caktonin vetes, 23 për qind tatim mbi të ardhurat. Të gjorët ata. Kështu që le ta ndërpresin caktimin e rrogave vendit dhe milionat e eurove që fitojnë

le t'i shpërndajnë në formën e fitimit si dividend, pse ka menduar kjo qeveria jonë t'jua bëjë 8 për qind, nga 15 për qind që ishte në vitin 2018! Është kjo pjesë e pafidrejtësisë së madhe shoqërore (shpëton moralisht vetëm zvkryeministri i sotëm që e deklaroi publikisht mendimin e tij kundër kur u miratua Buxheti i shtetit 2019 në dhjetor në Kuvend), që po i detyron edhe shqiptarët që kanë para, por që nuk e kanë kapur qeverinë, të duan të ikin një orë e më parë nga Shqipëria. Është kjo shpërndarje tërësisht e pabarabartë e të ardhurave që krijohen këtu tek ne (dhe pastaj rishpërndarja jo e duhur nga Buxheti i shtetit, pa i dhënë pjesën e luanit bujqësisë dhe turizmit që pëllin vende të reja pune-jo rrugëve!), që po vret orë e çast shpeshën se vendi ynë mund të bëhet një ditë shtet i së drejtës dhe i prosperitetit të të gjithë shqiptarëve.

HOROSKOPI

DASHI

Të lindurit e kësaj shenje mund të kenë një mosmarrëveshje të vogël me personat që iu rrethojnë. Ka gjasa që të keni një keqkuptim me një nga kolegët në punë ose me partnerin tuaj në biznes. Në mënyrë që situata të mos përkeqësohet, bëni mirë që të reagoni me qetësi.

DEMI

Gjatë ditës së sotme do të takoni dikë që do t'jua ndriçojë ditën. Do të shënoni sukses si në aspektin profesional ashtu edhe në atë personal. Në jetën personale duhet të silleni si një diplomat. Shmangni pyetjet e panevojshme.

BINJAKET

Për Binjakët, kjo ditë mund të hapë perspektiva të reja në aspektin profesional. Gjërërat do të varen nga vizioni tuaj. Mund t'i bëni ballë një sfide shumë të vështirë. Ka gjasa që i suksesi i kësaj dite të përçqendrohet tek financat.

GAFORJA

Gaforet mund të kenë nevojë për mbështetje morale. Rrezikoni të gaboni, ndaj tregohuni shumë të kujdesshëm. Përpiguni të mos pushtoheni nga paniku, pasi kështu nuk do të arrini të zbatoni asnjë nga planet tuaja. Duhet të tregoheni pozitiv kur komunikoni me të tjerët.

LUANI

Disa Luanë do të përballen me disa telashe gjatë ditës së sotme. Do t'ju duhet ndihma e një prej familjarëve tuaj. Do të gjendeni në dilemë, çfarë do t'ju shpërndrojnë nga puna. Në mbrëmje ia vlen të mendoni vetëm për t'u relaksuar.

VIRGJERESHA

Përpiguni të analizoni personalitetin e kujt do me të cilin komunikoni nga afër. Kjo do t'ju ndihmojë shumë si në aspektin personal ashtu edhe në atë profesional. Nuk përjashtohet mundësia e suksesit në profesion. Tregohuni të kujdesshëm me shëndetin.

PESHORJA

Për disa Peshore, kjo e hënë do të jetë vazhdimi i fundjavës. Shfrytëzoni këtë rast për anën tuaj personale. Në fund të ditës, mund të trishtoheni për shkak të disa kujtimeve të pakëndshme që do t'ju vijin në mend.

AKREPI

Akrepët do t'i përkushtohen sot vetëm biznesit. Do të ndihni shumë energjikë dhe kjo do t'ju ndihmojë të ndërmerri një iniciativë të rëndësishme. Do të ishte mirë që mbrëmjen t'ia kushtoni familjes.

SHIGJETARI

Shigjetarët do të kalojnë përgjithësisht një ditë të zakonshme. Financat do të kërkojnë vëmendje të veçantë. Mund t'ju duhet të bëni një blerje që e kalon buxhetin tuaj. Shmangni borxhet dhe mos bëni premtime të kota.

BRICJAPI

Për Bricjapët, detyra kryesore e kësaj dite do të jetë të bëni aleatë të rinj. Kjo do t'ju ndihmojë si nga ana personale ashtu edhe profesionale. Ka gjasa që sot t'i kushtoni shumë vëmendje edhe parajohjes suaj të jashtme. Në mbrëmje do të ndihni të lodhur por gjithsesi do të kaloni momente të këndshme nën praninë e partnerit/partneres suaj.

UJORI

Ujorët duhet të tregohen shumë të vëmendshëm gjatë ditës së sotme, pasi mund të dëmtoheni fizikisht. Bëni kujdes me fjalët kur bisedoni me dikë për të cilin dyshoni se është manipuluar. Ujorët bëgarë nuk duhet të shkojnë vetëm pas bukurisë.

PESHQIT

4 shkurti do të jenë një ditë me triumfë. Ka shumë mundësi që të keni sukses në realizimin e një projekti. Nuk përjashtohet as mundësia që të ndihni shumë të kënaqur me jetën tuaj personale, p.sh: mund të ribashkoheni me partnerin/partneren tuaj.

Është skandalozë vetëm ta mendosh, imagjino të përjetosh një situatë të tillë! Një klub i ashtuquajtur profesionist, që lë 4 muaj lojtarët pa paguar, në një konflikt të gjatë mes aksionerit shtet dhe aksionerit privat sheh 8 titullarë të bojkotojnë (me të drejtë) ndeshjen e radhës. Kjo nuk i ka lënë shije të mirë trajnerit Gjoka, që pret zgjidhje për situatën, përndryshe është i

detyruar të rishohë pozicionin e tij.

7-8 lojtarë refuzuan të luajnë ndeshjen. Apel për klubin?

Unë mendoj se gjendja është kjo që është. Uroj dhe shpresoj që njerëzit që na drejtojnë, ta zgjidhin sa më shpejt. Ne mundohemi të punojmë, por kaq është mundësia.

Ka një ultimatum edhe të stafit teknik?

Nuk është çështje ultimatum, duhet zgjidhur situa-

Trajneri i Kamzës nuk e pranon situatën

Gjoka: Pres zgjidhje nga presidenca, përndryshe largohem!

ta. Njerëzit duhet të mbajnë familjet dhe kanë nevojë për financa. Dihet që dy drejtuesit kanë prishur marrëdhëniet, dhe kjo ndikon te skuadra.

Keni ndeshjen e kthimit me Vilazninë në Kupë këtë

javë...

Unë uroj të zgjidhen, që skuadra të jetë e qetë. Unë e përgatis ta hedh në fushë, kur e kam të qetë, mendoj se mund të shkojnë mirë. Kur gjërat rëndohen, mund të them më shumë. Jemi në

një moment shumë delikat. **Zisi, Peçi, Mumajesi bënë një ndeshje të mirë, që nuk kanë pasur shumë minuta më parë...**

Në këto momente, jam i kënaqur me të gjithë që mu përgjigjen. Nuk ka lidhje të

them emra të përveçëm. Ata që u futën në fushë, dhanë maksimumin. Do i vlerësojmë dhe ata.

Çfarë e mban një trajner në këtë pozicion që jeni ju sot?

Mendoj se do i jap dhe pak kohë presidentit, dhe nëse nuk e qetëson dot skuadrën, jo unë, por askush nuk do punoj dot. Nuk është çështje dorëheqje, por nëse nuk motivoj dot lojtarët në stërvitje, për çfarë do duhem.

Kamzalinjtë 4 muaj pa u paguar, kryeqytetasit s'forcohen. Gjirokastritët fitojnë 2-0 në Kurbin



Jeton Selimi

E padëgjuar që tetë lojtarë të formacionit të mos pranojnë të zbresin në fushë vetëm pak minuta nga nisja e ndeshjes. Por edhe kjo ndodh në futbollin shqiptar dhe fatin të përballet me një rival të cunguar i takoi Partizanit. Me këtë dhuratë të marrë nga Kamza, të kuqtë e kryeqytetit kalojnë transferetën e javës së 20-të dhe presionin e rivalëve të Kukësit që përkohësisht kishin ngushtuar distancën.

Por ajo që u parashikua të ishte një shtetje, nuk rezultoi aspak e tillë, ndoshta nga motivimi apo mëshirimi ndaj një kundërshtari në "hall". Fakt është që të beuarit e Gegës u mjaftuan me golin e vetëm të Asanit në pjesën e dytë për të dalë me tri pikë nga fusha e lojës.

Frakcioni i parë nuk tregon asnjë problem te Kamza, madje janë vendasit që rrezikojnë më shumë. Zisi bën gjithçka mirë në krahun e tij, por shokët nuk e ndihmojnë si duhet. Të pakta daljet e të kuqve, që nuk bëjnë më shumë se rivalët, ndërsa pushimi do t'i

**Partizani rikthehet në +5
Luftëtari befason Laçin**

8 lojtarë të Kamzës bojkotojnë ndeshjen me të kuqtë



SUPERLIGA		
JAVA E 20-TE		
TE PREMTEMEN		
Tirana - Teuta		1-1
TE SHITUNEN		
Kastrioti - Skënderbeu		2-1
Flamurtari - Kukësi		1-2
TE DIELEN		
Laçi - Luftëtari		0-2
Kamza - Partizani		0-1
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	20	43
Kukësi	20	38
Teuta	20	35
Laçi	20	31
Skënderbeu	20	30
Flamurtari	20	29
Tirana	20	21
Luftëtari	20	20
Kastrioti	20	16
Kamza	20	15

gjente skuadrat me rrjeta të paprekura. Me rikthimin në fushë, muzika ndryshon dhe në të 55-ën, Partizani arrin të zhblokojë sfidën me Jasir Asanin. Edhe pritshmëritë e tjera se Partizani do ta kishte të lehtë të vriste garën do të rrezoheshin. Të kuqtë ulin ndjeshëm ritmin e lojës, por kjo mund t'u kushtonte shtrënjtë, pasi në minutën e 74-ët, Mehmeti tremb kryesuesit me goditjen e tij që shkon pak larg mbi traversë. Ky ishte rasti i fundit i sfidës, ndërsa me golin e Asanit Partizani merr atë që kërkonte nga transferta e Kamzës. Tri pikë që kthejnë distancën e sigurisë në krye të renditjes dhe kalojnë presionin te ndjekësit. Vëshitirë të gjej fjalë dhe të parashikosh të ardhmen e Kamzës, në fundin e ren-

ditjes dhe me një mal prolemesh për të kaluar...

LUFTËTARI BEFASON LAÇIN

Laçi priste në Kurbin zikaltërit e Luftëtarit, në një ndeshje që në letër dukej një trepikësh i garantuar për të zotët e shtëpisë. Bardhezinjtë e Prengës vinin në këtë përballje pas barazimit me Kukësin, ndërsa Luftëtari me moralin e dërrmuar pas shkatërrimit që pësoi në shtëpi nga Kastrioti me shifrat 5-1. Gjithsesi në Kurbin do të ndodhë befasia e madhe. Gjirokastritët do të shënojnë dy herë në pjesën e parë me anë të grekut Koçonis në minutën e dytë, një gol fantastik me roveshatë dhe me anë të Albano Aleksit, që vulosën suksesin në ndeshjen debutuese të Julian Ahmetajt në stolin zikalter.

Shifrat e korçarëve janë të frikshme

Ecuria e Skënderbeut është për... Kategori të Parë!



kishte provuar shijen e 6 humbjeve radhazi, as në vitin kur mbijetoi me shpirt në dhembë mes shumë peripeçish para se të fillonte ciklin e ri të sukseseve. Një seri e tillë negative është

të shijuar për herë të fundit në 11 vite më parë, në sezonin 2007-2008. Atëherë skuadra luftonte për mbijetesë, siç kishte ndodhur me vazhdimësi edhe në edicionet e mëparshme ku ulej


dhe ngjitej nga Kategoria e Parë. Në atë sezon, Skënderbeu regjistroi tri seri negative, prej 7, 8 dhe 11 ndeshjesh radhazi. Seri të cilat sigurisht që i garantuan vendin e fundit në klasifikim me vetëm 11 pikë pas 33 javësh, plot 23 pikë më pak se Besëlidhja që asokohe doli e parafundit dhe u kthye në të parën me korçarët. Sigurisht, skuadra aktuale ka pak të bëjë me atë të 11 viteve më parë sa i përket përbërjes cilësore, por nëse rezultate të tilla vazhdojnë edhe në vijim, në Korçë duhet të fillojnë të mendojnë si të sigurojnë sa më shpejt pikët e mbijetesës, para se të flasin për t'u kthyer "aty ku është mësuar të qëndrojnë" kjo skuadër.

Postimi emocionues i Kanavaros

Fanella e fundit e Hamshik dhuratë për ish-kapitenin

Pas 12 vitesh duke bërë historinë tek Napoli, Marek Hamshik është gati të largohet. Me një rekord prezençash (520) dhe golash (121), sllovaku do të kalojë në Kinë ditët në vijim, tek ekipi i Dalian Jifang, ku për 3 vite do të marrë plot 27 mln euro. Fanellën e ndeshjes së fundit, që Napoli luajti ndaj Sampdorias, Hamshik ka vendosur t'ia dhurojë një njeriu të veçantë, pikërisht ish-kapitenin të napolitanëve, Paolo Kanavaro. Në fanellën me numrin 17-të, ai shkruan: "Kapitenit tim Paolo, me vlerësim dhe respekt." Në një postim në Instagram, është Paolo Kanavaro, i cili shkruan: "Ja tek jemi. Për fat të keq, dita që asnjë tifoz i Napolit nuk do e donte ka arritur. Por për fat të keq, në jetë çdo gjë ka një fillim dhe një fund. Por në këtë pikë, ti ke bërë diçka të jashtëzakonshme. Në fund të një periudhe, shumë lojtarë harrohen menjëherë, disa pak vite më vonë. Por, për një gjë jam i sigurt, se emri MAREK HAMSHIK do të kumbojë gjithmonë në rrugicat e qytetit tonë. Faleminderit që më dhe emocione dhe për bluzën e fundit të veshur plot me dashuri. Hamshik një nga ne, faleminderit për gjithçka."

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Janë rivalë.
12. Kurosawa, regjisori i Rashomon
14. Janë fushat sportive.
15. Memoria në computer
16. Inicialet e Konicës.
18. Halili këngëtare
19. I famshmi Pacino.
20. Ishin kalorësit e Karlit të Madh
23. Fundet pa fund.
24. Eshtë shenjë goditjesh.
26. Giberna në MotoGP.
28. Janë kulla në xhami.
29. Ente Tregtare Durrës.
30. Janë temperaturat më të ulëta.
31. Christian i modës
33. Pak anakronike.
34. Erwin që thirrej Dhepra e shkretëtirës.
36. Eshtë garë sipërmarrësish.
39. Në fillim të verës
40. Diego pa çifte.

42. Të fundit në tender.
43. Mund të jenë kuzhine.
45. Mbyllin një krah
46. Merrret nga ai që çan ferrën.
49. Kufij itinerari.
50. Një... italiane.
51. Një treshe në skenë.
52. Ka ndodhur.

VERTIKAL

1. Jessica Parker aktore.
2. Basinger aktore.
3. Mbetur në fund.
4. Fillojnë nazet.
5. Të parat në stadium.
6. Parashtesë për gjysmë.
7. Një mund të jetë ekspres
8. Janë ndalime në pranga.
9. Marina këngëtare italiane.
10. Mund të jetë autonome.
11. Një sallë për drama.
13. Eshtë laps.
16. Eshtë bota e luleve
17. Trëndafil i Japonisë.
20. Një bukë që hahej me qofte.
21. Janë kapo kozakë.
22. Ndryshon një çdo ditë.
25. Punon në galeri.
27. Emri tjetër i Esaut.
29. Emri i dikurshëm i Tokyo-s
30. Një mund të jetë arkëtimi.
32. Një vrap pele.
34. Kujtohet ne nostalgji në pleqëri.
35. Franz kompozitor
37. Një lumë i yni.
38. Mbarojnë fare.
41. Qerre pa qe.
44. Ente Industriale Rajonale.
47. Qendër në kaos.
48. Inicialet e Gide.
50. Diftong në duar.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. U shpik nga Volta.
5. Janë si kasolle
11. Negri ppete italiane.
12. Mund të jenë edhe plehrash.
14. Fillojnë raportin
15. Mbarojnë kurse
16. Emër djali.
17. Sharif aktor.
19. Ai dhe ajo.
21. U verbua nga Askush
24. Kanë mbetur në klasë.
26. Ishte djali tjetër i Odiseut.
27. Topat pa kufij.
29. Janë edhe ato ultraviolet.
30. Në krye të noterëve.
31. Një Baba përrallor.
32. Rrota pa ekstreme.
34. Mund të jetë diesel.

VERTIKAL


37. Ashtu qoftë... o hoxhë!
38. Lidh computerin me telefonin një i tillë.
40. Një pjesë e gastritit.
41. Lumi i Bernës.
43. Janë pikat në statut.
44. Janë çift në gjethe.
46. Mc... shigjeta e argjendtë.
48. Pam aktore.
50. Thahen me bonifikime.
51. Paguhet një për vonesa

VERTIKAL


1. Ato biometrike nuk kanë nevojë për viza
2. Lindin në kokë
3. Nota e diapazonit
4. Janë të përpjeta.
5. Një këngëtar lirik.
6. Mbyllin një dyqan.
7. Mbarojnë fare
8. Eshtë grimcë me bërthamë.
9. Eshtë lloj papagalli.
10. Paguhet për shërbim.
12. Mund të jenë kasketa.
13. Personazh i njohur i Woody Allen.
18. Flet për Pegason dhe Belerofontit.
20. Eshtë anë kryesore gjaku.
22. Eshtë dukuria.
23. Besim pa kufij
25. Si stinore.
28. Mund të ishin bukanierë.
31. Mbyllin portat.
33. Claude-Oscar piktor.
35. Eshtë shkronjë e rezistencës
36. Lumë në Francë.
39. Pak dendësi.
42. Rastet pa set
45. Fillojnë detyrën.
47. Rastisin në krye.
49. Inicialet e Magritte piktor.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

9			4					2
2			8		6			7
		4		1				6
	1	7		4			3	5
6								9
	7	9			3	4		
			4	7			1	
6								
			6				2	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	5	1	4	9	7	2	8	6
9	4	2	5	8	6	1	3	7
6	7	8	1	2	3	9	4	5
1	2	7	9	3	5	8	6	4
5	8	6	2	4	1	3	7	9
4	9	3	6	7	8	5	1	2
2	3	5	7	1	4	6	9	8
7	1	9	8	6	2	4	5	3
8	6	4	3	5	9	7	2	1

Argëtim filozofik

- Kuraja është ajo që duhet për t'u ngritur dhe për të folur; kuraja është gjithashtu ajo që duhet për t'u ulur dhe për të dëgjuar.
- Kritika mund të mos jetë e pëlqyeshme, por është e nevojshme. Ajo përmbush të njëjtin funksion si dhimbja në trupin njerëzor. Kërkon vëmendje që gjendja e gjërave të jetë e shëndetshme.
- Vështirësitë e nënshtrua janë mundësi të fituara.
- Mos lejoni që planet e mëdha për një botë të re të shmangin energjitë tuaja nga ruajtja e asaj që ka mbetur nga bota e vjetër.
- Ngrënia e fjalëve kurrë nuk më ka shkaktuar mostrejë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	9	3	18	15	1	16	13	1	1
3	9	2	12	10	1	9	8	1	12	1
4	1	18	15	3	9	2	18	3	8	3
10	8	16	3	4	3	17	4	6		
3	12	1	15	2	8	1	11	2	7	8
12	3	3	15	9	1	11	7	9	15	
3	3	18	1	6	12	1	8	3	2	
8	19	1	9	19	6	9	3	16	8	
13	6	10	10	3	18	2	11	8	3	
5	1	9	2	3	4	2	2	4	1	8
1	11	3	1	9	3	12	1	18	1	9
8	11	6	19	1	4	3	7	1	2	8

M	A	S	H	U	R	K	A	I	R	A	K
E	S	T	E	R	A	D	H	U	N	A	
I	T	E	A	T	E	R	M	I	N		
E	R	A	P	O	L	A	R	T	A		
K	E	L	P	O	L	E	M	I	K	A	T
L	P	O	L	I	G	A	M	I			
E	T	A	P	I	K	A	T	R	E	L	
K	O	M	O	D	E	N	T	O	K	E	
T	R	I	S	E	T	M	N	U	N		
I	T	T	U	T	U	I	T	I	D		
K	A	D	E	T	K	O	S	H	L	E	
E	T	I	K	S	E	K	S	E	R	E	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

P	E	T	R	I	K	A	A	S	P	A	K
T	R	U	P	T	A	L	E	N	T	I	A
T	B	E	L	S	A	N	D	O	K	A	N
B	A	K	U	N	I	N	A	N	E	M	I
T	A	M	A	R	O	C	I	I	H		
P	I	E	N	A	O	D	R	E			
A	C	T	O	N	E	K	K	A	O	S	
R	A	T	R	A	D	E	A	L	M	A	P
K	E	M	A	P	E	T	E	E	A	P	
E	F	S	A	V	A	L	R	O	N	E	
R	I	T	M	A	L	L	A	R	M	E	T
M	A	B	U	S	E	H	A	N	E	T	
O	R	E	K	S	B	D	E	M	O	N	I
R	A	S	T	K	A	B	I	R	E	T	P
I	B	A	P	E	R	I	T	O	N	I	T
A	T	K	I	M	B	O	I	R	K		
R	A	S	A	P	A	G	A	N	I	N	I
T	A	V	E	R	A	D	O	I	M		
V	M	A	R	S	I	A	N	E	T	J	A
M	A	J	A	T	O	R	M	A	T		
H	A	R	A	K	I	R	I	E	R	I	T
A	S	I	R	A	D	A	M	E	S		
S	H	A	M	A	T	A	L	O	T	U	S

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- - Gjithkush ka një ditë të keqe dhe disa ditë janë më të gjata se të tjerat.
- - Për të mirë e për të keq, zotërimi i ajrit është sot shprehja supreme e fuqisë ushtarake dhe flotat dhe ushtritë, edhe pse vitale dhe të rëndësishme, përsëri duhet të pranojë se kanë rang vartësi.
- - Për rolin tim, them se do të jetë më mirë sikur të gjitha partitë t'ia lënë të kалуaren historisë, veçanërisht tani që propozoj ta shkruaj historinë vetë.
- - Që nga Stetin në Baltik, tek Trieste në Adriatik, një perde hekuri ka zbritur përmes Kontinentit.

